**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE**

# KONCEPT DOKUMENTI PËR ÇËSHTJEN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË PAJUSTIFIKUESHME

*Prill 2021*

# Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE E KONCEPT DOKUMENTIT....4

HYRJE....6

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT....6

1.1 STANDARDET BASHKËKOHORE NDËRKOMBËTARE....9
1.2 KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LEGJISLATIVE E KOSOVËS NË FUSHËN E KONFISKIMIT TË PASURISË....13
1.3 PROBLEMI KRYESOR....24
1.3.1 SHKAQET....25
1.3.2 EFEKTET....30
1.4 PALËT E INTERESIT NË BAZË TË PËRKUFIZIMIT TË PROBLEMIT....31

KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT....34

KAPITULLI 3: OPSIONET....34

3.1: OPSIONI STATUS QUO (PA ASNJË NDRYSHIM)....34
3.2: OPSIONI I PËRMIRËSIMIT TË ZBATIMIT TË KORNIZËS AKTUALE LIGJORE PA NDRYSHIME LEGJISLATIVE....36
3.3 OPSIONI I MIRATIMIT TË LIGJIT TË RI I CILI MUNDËSON REALIZIMIN E KONFISKIMIT TË PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË PAJUSTIFIKUESHME EDHE NË MUNGESË TË NJË AKTGJYKIMI DËNUES....38

KAPITULLI 4: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË TË ARDHMEN....52

4.1 IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE PËR OPSIONIN E TRETË....54
4.2 SFIDAT NË GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE....59

KAPITULLI 5: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI....59

KAPITULLI 6: KRAHASIMI I OPSIONEVE....62

6.1 PLANET ZBATUESE TË OPSIONEVE TË NDRYSHME....64
6.2 TABELA E KRAHASIMIT ME TRE OPSIONET....64

KAPITULLI 7: PËRFUNDIMI DHE HAPAT E ARDHSHËM....66

7.1 DISPOZITAT PËR MBIKËQYRJE DHE VLERËSIM....67

SHTOJCA 1: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN EKONOMIK ....................................... 68

SHTOJCA 2: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMET SHOQËRORE .................................... 71

SHTOJCA 3: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMET MJEDISORE ...................................... 76

SHTOJCA 4: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN E TË DREJTAVE THEMELORE ....... 79

SHTOJCA 5: VLERËSIMI I RËNDËSISË........................................................................... 82

# Përmbledhje e Koncept Dokumentit

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| **Titulli** | Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë se fituar në mënyrë të pajustifikueshme |
| **Ministria bartëse** | Ministria e Drejtësisë; Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) |
| **Personi kontaktues** | Lulzim Beqiri, Drejtor, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë |
| **PPQ** | Prioriteti 2: Sundimi i Ligjit |
| **Prioriteti strategjik** | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020 – 2023 – Objektivi 2 (Sundimi i Ligjit). |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme |
| Përmbledhje e konsultimeve | Ky Koncept dokument është lancuar në platformën online të konsultimeve publike nga data 27.05.2020 deri më 17.06.2020. me anë të së cilës kemi pranuar komente. Komente poashtu janë marr edhe përmes e-mailit të cilat janë dërguar përmes postës elektronike. |
| | |
| Opsioni i propozuar | **Hartimi i projektligjit** |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Me anë të këtij Koncept dokumenti synohet që nëse ka mundësi brenda kufijve buxhetor ekzistues të përgjithshëm të arrihet të ketë sa më pak ndikime por megjithatë gjatë hartimit të Projektligjit do të saktësohet kostoja buxhetore |
| Ndikimet ekonomike | Ndikime të pritshme pozitive ekonomike përmes krijimit të hyrave ku do të derdheshin të mirat materiale të konfiskuara. |
| Ndikimet shoqërore | Ndikime të pritshme pozitive sociale përmes zbatimit më efikas të sistemit të konfiskimit në vend dhe rrjedhimisht luftimit më të suksesshëm të krimit dhe siguri më të madhe në vend. |

| | |
|---|---|
| Ndikimet në të drejtat e njeriut | Ndikimet e ndërlidhura më të rëndësishme kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, përkatësisht të drejtën e një personi për pronë, të drejtën për një gjykim të drejtë, procedurat që kryhen brenda një kohe të arsyeshme dhe mbrojtjen e të dhënave personale. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk pritet të ketë ndikime relevante për këtë kategori. |
| Testi i NVM-së | Marrë parasysh fushën e trajtimit të këtij Koncept Dokumenti, realizimi i testit të NVM është konsideruar i panevojshëm. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Hartimi i Projektligjit |
| Afatmesëm | Zbatimi i Projektligjit |

# Hyrje

***Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për Koncept Dokumentin***

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë se fituar në mënyrë të pajustifikueshme |
| Ministria bartëse | Ministria e Drejtësisë; Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave |
| Personi kontaktues | Lulzim Beqiri, Drejtor, Departamenti për Integrimet Evropiane dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë |
| PPQ | Prioriteti 2, Sundimi i Ligjit |
| Prioriteti strategjik | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020 – 2023 – Objektivi 2 (Sundimi i Ligjit) |
| Grupi punues | 1. Lulzim Beqiri, Kryesues, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Drejtësisë;<br>2. Blerim Sallahu, Shef i Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;<br>3. Ardian Bajraktari, Departamenti Ligjor, Ministria e Drejtësisë;<br>4. Gentrita Bajrami, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Drejtësisë;<br>5. Noliana Kusari, Departamenti Ligjor, Ministria e Drejtësisë;<br>6. Albina Shabani, Këshilli Gjyqësor i Kosovës<br>7. Mustafë Tahiri, Këshilli Gjyqësor i Kosovës;<br>8. Besim Kelmendi, Këshilli Prokurorial i Kosovës;<br>9. Naim Abazi, Këshilli Prokurorial i Kosovësl<br>10. Fatmir Karaliti, Policia e Kosovës;<br>11. Afrim Atashi, Agjencia kundër Korrupsionit<br>12. Flutra Blakçori, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës;<br>13. Alba Boshnjaku, Sekretariati Koordinues i Qeverisë;<br>14. Razije Murtezaj, Ministria e Financave dhe Transfereve. |

# Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Pasuria e fituar me kryerjen e veprave penale është nxitës kryesor i kriminalitetit. Kjo pasuri i siguron kryesve të veprave penale burime të mëtejme për të vazhduar aktivitetet

e tyre të paligjshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për krimin e organizuar dhe korrupsionin ku sfondi i konsiderueshëm ekonomik është thelbësor për funksionimin e rrjeteve kriminale. Duke ditur këtë, shumë shtete, përfshirë këtu edhe Kosovën, bëjnë përpjekje që të parandalojnë aktivitetet e tilla duke u siguruar që kryesit e veprave penale nuk do të përfitojnë nga veprimtaritë e tyre të paligjshme. Kështu, duke larguar motivin kryesor për ndërmarrjen e këtyre veprimeve, shtetet synojnë që të parandalojnë dhe të pengojnë funksionimin e grupeve kriminale.

Janë tre mekanizma kryesorë të cilët përdoren nga ana e shteteve evropiane dhe më gjerë në ndjekje të këtij qëllimi: konfiskimi penal, konfiskimi administrativ dhe konfiskimi civil. Pa marrë parasysh bazën e procesit konfiskues, qoftë kjo penale, administrative apo civile, duhet të nënvizohet se rëndësia e konfiskimit të të mirave materiale të cilat derivojnë nga aktivitetet kriminale është e shumëfishtë. Jo vetëm për faktin se një proces i tillë parandalon përsëritjen e aktiviteteve joligjore përmes largimit të burimit të tyre financiar, mirëpo edhe për faktin se ky mekanizëm adreson shqetësimet se pasuria e madhe kriminale rrezikon të destabilizojë sistemin financiar të një vendi dhe rrjedhimisht të korruptojë shoqërinë legjitime.

Thënë në tërësi, përderisa shtetet e ndryshme mund të ndahen në bazë të llojit të procedurës konfiskuese të cilën e praktikojnë, ato megjithatë bashkohen në njohjen e konfiskimit si çelës të luftimit të suksesshëm të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe si përkrahës të sundimit të ligjit dhe parimit moral se askush nuk duhet të përfitojë nga krimi.

Nga analiza e bërë për qëllime të këtij Koncept Dokumenti është vërejtur se mekanizmi i vendosur dhe më i pranueshëm për konfiskim është konfiskimi i realizuar përmes procedurës penale apo konfiskimi tradicional penal ku pas nxjerrjes së aktgjykimit dënues, gjykata, me kërkesë të prokurorisë dhe varësisht prej fakteve dhe provave të rastit, vendosë nëse pasuria e personit të dënuar duhet të konfiskohet apo jo. Kjo procedurë në fakt është rrjedha e zakonshme e procesit në të gjitha shtetet, duke mos përjashtuar këtu as Kosovën, dhe rrjedhimisht konsiderohet si opsion primar nëse ekzistojnë mundësitë për të mbështetur ndjekjen penale.

Megjithatë, ka raste kur një rrjedhë e tillë e procesit mund të mos jetë e disponueshme për prokurorinë shtetërore. Shpesh herë ndodhë që prokuroria nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të lidhur pasurinë e personit të dënuar me veprën penale të kryer, apo ndodhë që hetimi të bllokohet dhe si rezultat kryesi i veprës penale arrinë që të ikë apo të shpërndajë pasurinë e tij. Nuk janë të rralla as rastet kur stili i jetesës së personave të caktuar nuk korrespondon me të ardhurat e deklaruara dhe ndonëse ekziston dyshimi se pasuria e

pajustifikueshme e këtyre personave është e lidhur me vepra penale, është jashtëzakonisht e vështirë që të dëshmohet një gjë e tillë. Të gjitha këto raste dhe më shumë, pamundësojnë konfiskimin e pasurisë sipas procedurës së zakonshme penale.

Duke pasur në mendje këta skenarë, gjatë dekadave të fundit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për hartimin e rregullave të drejta dhe efikase të cilat u mundësojnë organeve shtetërore të kapin të mirat materiale të cilat dyshohet se nuk kanë origjinë legjitime. Në ndjekje të këtij synimi, është vërejtur se konfiskimi penal në fakt paraqet vetëm njërën anë të medaljes në përpjekjet e një shtetit për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ana tjetër e medaljes ka të bëjë me konfiskimin civil, procedurë kjo e cila mund të inicohet edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues.

Përderisa konfiskimi i pasurisë duke u bazuar në aktgjykim dënues për kryerjen e veprës penale është mirë i rregulluar në Kosovë, zhvendosja e fokusit prej aspektit penal në atë civil bënë që debati të marr natyrë më kontraverse për dy arsye.

Së pari, konfiskimi i pasurisë, si koncept, është veprimtari praktike e cila ilustron gatishmërinë e organeve të ndjekjes së një vendi për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në vend. E njëjta njëherit shërben edhe si garantuese për qytetarët se të gjithë ata që merren me aktivitete joligjore nuk do t'i gëzojnë të mirat materiale të cilat rrjedhin nga këto veprimtari dhe nuk do t'i përdorin të njëjtat për të shtuar tutje nivelin e krimit në vend. Nga ajo çfarë kemi parë deri tani, numri i vogël i konfiskimeve të ekzekutuara në Kosovë nuk ka bërë punë të mirë në dërgimin e këtij mesazhi. Kjo për faktin se në gjashtë vitet e fundit, vlera e ngrirjeve dhe sekuestrimeve kap vlerën prej 180,000,000.00 Euro, përderisa vlera e konfiskimeve përfundimtare bie në vetëm 3.5 milion Euro.

Së dyti, marrë parasysh historinë e Kosovës si vend i dalë nga lufta dhe në tranzicion, konfiskimi me bazë civile, gjegjësisht implementimi i suksesshëm i tij, nuk do mend se është çështje tejet e ndjeshme. Në Kosovë, çështja e definimit të pronësisë dhe prejardhjes së pasurisë është shumë problematike. Ndër shkaqet kryesore për këtë janë informaliteti sa i përket pasurisë së trashëguar, remitancat e diasporës dhe kontratat jo formale të shitblerjes.

Ndaj, ky Koncept Dokument do t'i kushtojë vëmendje të veçantë të dy këtyre çështjeve. Për të bërë këtë, së pari, Koncept Dokumenti do të analizojë kornizën legjislative të vendit në fushën e konfiskimit të pasurisë joligjore me qëllim të identifikimit të problemeve në zbatimin e suksesshëm të saj, për të vazhduar pastaj me shtjellimin e opsioneve përmes të cilave synohet adresimi dhe përfundimisht zgjidhja e tyre.

## 1.1 Standardet Bashkëkohore Ndërkombëtare

Gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë ka marrë parasysh një numër të instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme. Kjo për arsye se pavarësisht opsionit i cili zgjedhet, pritja dhe synimi kryesor i këtij Koncept Dokumenti është që korniza ligjore e Kosovës në lidhje me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme të jetë sa më e përafërt me standardet bashkëkohore ndërkombëtare, posaçërisht me ato të Bashkimit Evropian dhe me praktikat më të mira të shteteve anëtare.

Para se të lëshohemi në elaborim të këtyre standardeve, është e rrugës të theksohet se pavarësisht përpjekjeve dhe tendencave për të ndërtuar standarde unike në fushën e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, në nivelin ndërkombëtar ende nuk është arritur një metodologji unike dhe e standardizuar si për nga aspekti i procedurave ligjore ashtu edhe nga aspekti i strukturës përmbajtësore dhe natyrës së ligjeve. Megjithatë, kjo asesi nuk nënkupton se nuk ka parime të përgjithshme të cilat vlejnë në nivel ndërkombëtar sa i përket konfiskimit të pasurisë. Përkundrazi, përderisa qasja mund të dallojë në aspekte teknike dhe procedurale nga vendi në vend, është e rëndësishme që të gjitha instrumentet ndërkombëtare të kësaj fushe theksojnë rëndësinë e konfiskimit si instrumenti më efektiv ligjor për luftimin e kriminalitetit në vend.

Në këtë drejtim, konventa e parë e cila rregullon çështjen e konfiskimit të pasurisë është **Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotropike** e vitit 1988 (Neni 5)[1]. Bazë tjetër ligjore gjendet në **Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtarë**[2], përkatësisht Nenet 12-14 që rregullojnë konfiskimin dhe marrjen e sendeve, bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me konfiskimin, dhe çështjet e disponimit me të ardhurat nga krimi apo i pasurisë së konfiskuar. Dispozita të ngjashme parashikon edhe **Konventa Ndërkombëtare kundër financimit të Terrorizmit** (Neni 8) [3].

Tutje, **Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit[4],** e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 58/4 të 31 tetorit 2003, është instrumenti themelor, global dhe më i kompletuar në fushën e luftimit të korrupsionit. Kjo Konventë është relevante për qëllime të këtij Koncept Dokumenti marrë parasysh faktin se e njëjta ka për qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe nxitjen

---

[1] Shih https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/illicit-trafficking.html.
[2] Shih https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/intro/UNTOC.html.
[3] Shih https://www.un.org/law/cod/finterr.htm.
[4] Shih https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/.

e lindjes së mekanizmave institucionalë të cilët adresojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë me origjinë të jashtëligjshme.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit bënë thirrje që secili shtet palë, në masën më të madhe të mundur brenda sistemit të brendshëm ligjor, të merr çfarëdo masa që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e të ardhurave që rrjedhin nga veprat penale dhe pasurive, pajisjeve apo mjeteve të tjera të cilat mund të përdoren apo janë të destinuara të përdoren për kryerjen e veprave penale. E njëjta Konventë tutje nxitë shtetet që të shqyrtojnë mundësinë e kërkimit që kryesi i veprës penale të dëshmojë origjinën e fitimeve të prezumuara nga vepra penale apo çdo pasurie tjetër e cila i nënshtrohet konfiskimit (Neni 31, pika 8 e Konventës).

Dispozita të ngjashme përmbahen edhe në **Dyzet Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar[5].** Task Forca e Veprimit Financiar u krijua në vitin 1989 gjatë Samitit G7 në Paris si organ ndërqeveritar dhe instrument ndërkombëtar i luftës kundër shpëlarjes së parave të pista. Ky organizëm multi-disiplinor dhe themelor në luftën kundër shpëlarjes së parave, ka për qëllim që të harmonizojë politikat e shteteve anëtare në fushën e shpëlarjes së parave. Këto dyzetë rekomandime përbëjnë bazën e çdo tentative për të luftuar shpëlarjen e parave dhe janë të pranuara nga më shumë se njëqind e tridhjetë shtete anë e mbanë botës.

Për fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti, i rëndësishëm është Rekomandimi i Katërt i Task Forcës së Veprimit Financiar i cili i bënë thirrje shteteve që të konsiderojnë miratimin e masave që lejojnë konfiskimin e të ardhurave ose instrumenteve, pa kërkuar një dënim penal, ose të cilat kërkojnë nga një shkelës të demonstrojë origjinën e ligjshme të pasurisë, e cila pretendohet se mund t'i nënshtrohet konfiskimit, deri në atë masë që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e ligjeve të aplikueshme në vendet përkatëse.

Në nivel të Bashkimit Evropian, politika e konfiskimit të pasurisë me origjinë të jashtëligjshme është avancuar gradualisht përgjatë dekadave të fundit përmes një numri të vendimeve, rregulloreve dhe direktivave. Synim kyç i secilit një prej këtyre instrumenteve është mobilizimi i shteteve anëtare për të vendosur standarde në fushën e konfiskimit të pasurisë dhe të mirave materiale të përfituara dhe të përdorura për aktiviteteve kriminale dhe avancimi i vazhdueshëm i kësaj agjende.

Pararendëse në këtë drejtim është **Nisma 98/699 JHA për Veprim të Përbashkët e vitit 1998[6]** për pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin, konfiskimin

---

[5] Shih https://www.oecd.org/newsroom/2789371.pdf.
[6] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31998F0699&from=EN.

e dobive dhe të ardhurave nga krimi. Në përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin në mes të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, kjo Nismë për Veprim të Përbashkët ofron përgatitje, brenda fushëveprimit të operacioneve të Rrjetit Evropian për Gjyqësi, të udhëzimeve që përdoren lehtë për identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimit dhe konfiskimin e dobive dhe të ardhurave nga krimi.

I rëndësishëm është edhe **Vendimi Kornizë për pastrimin e parave, identifikimin, përcjelljen, ngrirjen, konfiskimin e mjeteve dhe të hyrave nga vepra penale (2001/500/JHA)[7].** Përmes këtij vendimi, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian obligohen që të ndërmarrin hapat e nevojshëm me qëllim të sigurimit të procedurave për konfiskimin e të hyrave të fituara me kriminalitet. Duke u thirrur në këtë vendim, Bashkimi Evropian përcaktoi se mund të konfiskohet edhe pasuria e ligjshme e vlerës përkatëse nëse nuk mund të konfiskohet dobia e paligjshme, si në procedurën që zhvillohet para organeve vendore ashtu edhe në procedurën sipas kërkesës së vendit tjetër.

Tutje, në vitin 2003, Bashkimi Evropian nxjerri **Vendimin Kornizë për zbatimin e urdhëresave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive (2003/577/JHA)[8].** Përmes Vendimit Kornizë për zbatimin e urdhëresave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive (2003/577/JHA), është bërë përcaktimi i rregullave dhe procedurave sipas të cilave shtetet anëtare të Bashkimit Evropian do të bëjnë njohjen dhe ekzekutimin e urdhëresave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive në territorin e tyre. Përmes këtij Vendimi përcaktohet procedura e shpejtë dhe efikase e zbatimit reciprok të urdhëresave për ngrirjen e pasurisë ose te dëshmive, apo alternativisht përcaktimi i kushteve specifike për refuzimin e ekzekutimit të urdhrave në fjalë.

Ky Vendim Kornizë i Bashkimit Evropian është i rëndësishëm për qëllime të këtij Koncept Dokumenti sepse përmes tij përcaktohen në mënyrë të qartë se urdhri për ngrirjen e pasurisë apo të dëshmive i referohet cilësdo masë të ndërmarrë nga ana e organit kompetent gjyqësor të shtetit nxjerrës me qëllim të pengimit të përkohshëm të shkatërrimit, transformimit, lëvizjes, bartjes ose disponimit me pasurinë e cila mund të jetë objektit i sekuestrimit apo konfiskimit të përhershëm.

Në vitin 2005, pas një analize që kishte bërë rreth implementimit të direktivave të deriatëhershme, dhe duke konsideruar që sektorë të caktuar të krimit të organizuar po vazhdonin të lulëzonin, Bashkimi Evropian doli me **Vendimin Kornizë 2005/212/JHA mbi Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar përmes Krimit[9].** Përmes këtij Vendimi, Bashkimi

[7] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32001F0500&from=GA.
[8] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32003F0577&from=EN.
[9] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005F0212&from=EN.

Evropian vendosi disa standarde të definuara mirë mbi atë se kur një konfiskim duhet të zë vend.

Ky vendim është i rëndësishëm sepse për herë të parë prezanton një përjashtim nga parimi që konfiskimi është i mundur vetëm brenda objektit të procedurës penale. Kështu, neni 2 (2) dhe neni 3 i këtij Vendimi përcaktojnë se shtetet anëtare mund të përdorin procedura të ndryshme nga procedurat penale për të privuar kryesin nga të ardhurat e fituara nga kjo vepër.

Vendimi Kornizë 2005/212/ JHA parashikon për herë të parë kompetencat e zgjeruara për konfiskim ose të ashtuquajturën konfiskim të zgjeruar në rastet të përcaktuara shprehimisht të veprave të rënda të kryera në kuadër të një organizate kriminale të mbuluar nga Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/475 / JHA e 13 qershorit 2002 për luftimin e terrorizmit (neni 3).

Ajo që është karakteristikë e këtij lloji të konfiskimit është se kur janë kryer vepra të tilla, është e mundur që të konfiskohet edhe prona që nuk është nxjerrë direkt nga veprimtaria kriminale në fjalë, pra një lidhje midis pasurive të fituara përmes veprimtarive kriminale të personit të dënuar. dhe vepra specifike nuk kërkohet. Vendimi parashikon një përjashtim tjetër nga parimi i lartpërmendur dhe lejon Shtetet Anëtare të përdorin procedura të ndryshme nga procedurat penale për të privuar kryesin e pasurisë në fjalë. Për herë të parë, Shteteve Anëtare u jepet diskrecion që të konfiskojnë pronat e fituara jo nga personi i dënuar, por nga palët e treta. Këto përfshijnë marrëdhëniet më të afërta të personit në fjalë, si dhe personat juridikë për të cilët personi i interesuar, qoftë i vetëm ose në lidhje me marrëdhëniet e tij më të ngushta, ka një ndikim kontrollues.

Më rishtazi, në vitin 2014, Parlamenti Evropian ka miratuar **Direktivën 2014/42/EU për ngrirjen dhe konfiskimin e përfitimeve të krimit në Bashkimin Evropian**[10] e cila përmbledh përkushtimin e Bashkimit Evropian për të shndërruar çështjen e konfiskimit të pasurisë në një prioritet më të madh dhe me kërkesa për të arritur rezultate konkrete në këtë drejtim. Në këtë Direktivë, është me rëndësi të theksohet se disa aspekte që lidhen me konfiskimin, serish u atribuohen në përgjegjësi shteteve anëtare.

Krejt së fundi, vetëm ditë më parë, më 19 mars 2020, Gjykata Evropiane e Drejtësisë në një komunikatë për media bëri të qartë se korniza ligjore e Bashkimit Evropian nuk i ndalon shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që të nxjerrin ligje me anën e të cilave lejohen konfiskimi civil i pasurisë në mungesë të një aktgjykimi dënues[11]. Komunikata në fjalë u

[10] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0042&from=EN.
[11] Shih https://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2020-03/cp200032en.pdf.

bë pasi që autoritetet bullgare i ishin drejtuar Gjykatës Evropiane të Drejtësisë me pyetjen se mund të nxjerrin shtetet anëtare të Bashkimit Evropian legjislacion për lejimin e konfiskimit të pasurisë edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues.

## 1.2 Korniza institucionale dhe legjislative e Kosovës në fushën e konfiskimit të pasurisë

Gjatë dy dekadave të fundit, drejtësia penale në Kosovë ka kaluar në një varg reformash institucionale dhe legjislative, ku rëndësi e veçantë i është kushtuar luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Përderisa rol krucial në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit prej vitit 1999 e deri në vitin 2014 kishin mekanizmat ndërkombëtarë si UNMIK dhe EULEX, nga viti 2014 këto kompetenca filluan të transferohen tek autoritetet vendore të cilat u pajisën me kompetenca për ndjekjen e kriminalitetit.

Sot, dymbëdhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, korniza institucionale e vendit tonë lidhur me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme përbëhet nga institucionet si në vijim:

- *Policia e Kosovës*
- *Prokurori i Shtetit*
- *Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar*
- *Gjykatat*
- *Koordinatori Nacional kundër Krimeve Ekonomike*

Secili institucion zbatues i ligjit ka përgjegjësinë e tij në sistemin e konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme, si vijon:

*Policia e Kosovës* bën ndjekjen e kryesve të veprave penale, identifikimin dhe mbledhjen e provave, hetimin financiar, identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve si dhe zbaton hetimin nën udhëheqjen e prokurorisë.

*Prokuroria* është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë së kundërligjshme, kufizimin e përkohshëm të pasurisë, paraqitjen e kërkesës për urdhër për sekuestrim të përkohshëm, ngrirjen e përkohshme të pasurisë, kërkesës për urdhër ndalues, kërkesës për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, përfshirjen e pasurisë së konfiskuar në aktakuzë, kërkesës për verifikimin e pasurisë së të dënuarit etj.

*Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar* ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën apo

organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore. E njëjta ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës së organeve kompetente, mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent, angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar, administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik.

*Gjykatat* në bazë të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës shqyrtojnë kërkesat e prokurorisë për urdhërimin e sekuestrimit të përkohshëm dhe vendosin lidhur me ato kërkesa, shqyrtojnë kërkesat për lëshimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë që është objekt i sekuestrimit sipas urdhrit dhe vendosin për masat e përkohshme konkrete të sigurisë, shqyrton kërkesat e prokurorisë për lëshimin e urdhrit kufizues që konsiston në ngrirjen e aseteve. Vendos përfundimisht lidhur me konfiskimin e pasurisë ku së bashku me aktgjykim urdhëron edhe konfiskimin. Gjithashtu, gjykata në bazë të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë vendos lidhur me kërkesën për verifikim të pasurisë si dhe mund të vazhdojë procedurat penale dhe procedurat për konfiskimin e zgjeruar në rastet e vdekjes, mungesës, çrregullimit ose paaftësisë mendore të të pandehurit.

*Koordinatori Nacional kundër Krimeve Ekonomike* ka përgjegjësi që të koordinojë, bashkërendojë, monitorojë dhe raportojë lidhur me implementimin e aktiviteteve dhe veprimeve sa i përket krimit të organizuar.

Secili prej këtyre mekanizmave kryen detyrat dhe kompetencat e veta në bazë në kornizës ligjore në fuqi në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme. Kjo kornizë konsiston prej akteve ligjore si në vijim:

- *Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK);*
- *Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (KPPRK);*
- *Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP);*
- *Ligji Nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (LAPSK);*
- *Udhëzimi Administrativ MD Nr. 05 /2017 për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara;*
- *Udhëzim Administrativ MD/ Nr.04/2017 për Mënyrën e Përcaktimit të Shpenzimeve të Ruajtjes dhe të Mbajturit e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;*

- *Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.*

***Kodi Penal i Republikës së Kosovës*** rregullon çështjen e konfiskimit të instrumentaliteteve dhe dobisë pasurore të fituara me vepra penale në Kapitullin VII. Neni 92, si nen i vetëm i këtij kapitulli, përcakton që mjetet dhe dobitë pasurore të përfituara me vepër penale konfiskohen dhe kur kjo nuk është e mundur, paguhet një shumë e barasvlershme apo konfiskohet çdo pasuri e të pandehurit me vlerë të barasvlershme.

***Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës*** parasheh një mori dispozitash të cilat rregullojnë çështjet që ndërlidhen dhe dërgojnë në konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme. Kodi parasheh fillimisht që në rastet kur hetimi është autorizuar për vepër penale nga neni 90 i Kodit, bllokimi i aseteve që janë përdorur për kryerjen e veprës penale nën hetim, që janë provë, apo janë fituar nga vepra penale nën hetim, mund të bëhet përmes *ngrirjes së përkohshme të aseteve* të trajtuar në nenin 264. Përveç kësaj, bllokimi i pasurisë që mund t'i nënshtrohet konfiskimit mund të bëhet përmes *masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë* të trajtuar në nenin 268 të KPP-së. Tutje, Kodi i Procedurës Penale rregullon edhe *sekuestrimin e sendeve*, në nenin 112, ku përcaktohet se me urdhër të gjykatës mund të bëhet sekuestrimi i sendeve që mund të jenë prova gjatë procedurës penale, sendeve ose pasurisë që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale. Sipas Kodit, sendet dhe pasuria e sekuestruar vendosen nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Si përfundim, Kodi përcakton edhe *konfiskimin e sendeve*, i cili bëhet nga gjykata me aktgjykim, nën kushtet që: prokurori i ka përcaktuar ato sende në aktakuzë; gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se të njëjtat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale si dhe nëse konfiskimi i tyre lejohet me ligj.

Pra KPPRK parasheh konfiskimin e pasurisë e cila është e lidhur me veprën penale për të cilën zhvillohet procedura dhe nuk zgjerohet më tej në pjesën tjetër të pasurisë së të pandehurit. Aktualisht po punohet në një kod të ri të procedurës penale i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2020 dhe i cili pritet të ketë dispozita më të avancuara që adresojnë konfiskimin e pasurisë.

***Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë*** hyri në fuqi në janar të vitit 2019 dhe zbaton Direktivën 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 3 prill 2014 mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë ligj përcaktohen kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat sipas KPPRK nuk mjaftojnë. LKZKP prezantoi një konfiskim kuazi-penal dhe shkon një hap më tej se KPPRK duke akomoduar nën kushte të caktuara konfiskimin edhe të pasurisë që nuk është e ndërlidhur me veprën e caktuar penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Procedura për konfiskimin e tillë mund të inicohet brenda një periudhe prej pesë vite pasi aktgjykimi dënues për veprat si më poshtë të ketë marrë formën e prerë: veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale të ndërlidhura me detyrën zyrtare; veprat penale kundër shëndetit publik; veprat penale të trafikimit me njerëz, skllavërisë dhe rrëmbimit; veprat penale seksuale; veprat penale lidhur me konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit; veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; veprat penale lidhur me terrorizmin; veprat penale lidhur me drogat; veprat penale lidhur me armët; veprat penale kibernetike; veprat penale kundër ekonomisë; veprat penale kundër pasurisë; veprat penale kundër ambientit; po ashtu në rast tentimi, shtytje, ndihme dhe marrëveshje për të kryer ndonjërën nga veprat penale të përmendura apo edhe në rast të çdo vepre penale që ka sjell përfitime materiale që tejkalojnë dhjetë mijë (10,000) euro.

Në rast të shpalljes fajtor për njërën nga veprat penale të përmendura, Prokurori i Shtetit bazuar në nenin 4 të këtij ligji, mund të paraqes kërkesën për verifikim të pasurisë së të pandehurit të dënuar, përfshirë çdo lloj prone që i pandehuri ka fituar brenda dhjetë (10) viteve para inicimit të fazës hetimore; apo është në pronësi ose në posedim të një pale të tretë për llogari ose përfitim të të pandehurit; ose i pandehuri i ka transferuar tek një palë e tretë e cila nuk ishte një blerës *bona fide*. Barra e provës më pas bie mbi të pandehurin i cili duhet të provojë prejardhjen legjitime të pasurisë, e edhe tek palët e treta përkitazi me pretendimet e tyre. Gjykata mund të lëshoj urdhrin për konfiskim nëse i pandehuri, nuk ka arritur të provoj se pasuria është fituar nga ai/ajo nga burimet e mjaftueshme legjitime që ka pasur në kohën kur fituar pronën dhe/ose nëse pala e tretë i paraqitur si blerës nuk është *bona fide.*

Fushëveprimi i këtij ligji përfshin edhe konfiskimin e përfitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penalen në rastet kur procedura penale nuk do mund të vazhdohet pasi që i pandehuri ka vdekur, në rast të mungesës, të çrregullimit ose të pa-aftësive mendore të tij, mirëpo gjykata bazuar në nenin 20 të këtij ligji duhet ta vazhdoj procedurën penale me qëllim të konfiskimit në rastet kur vlera e pasurisë që është objekt i konfiskimit të zgjeruar e kalon dhjetëmijë (10,000) euro dhe kur është në interes të drejtësisë që të vazhdohet me procedurat dhe të caktoj një avokat i cili do përfaqësonte interesat e palës.

Përderisa ky ligj pa dyshim se ka zgjeruar kompetencat e organeve ndjekese për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, dhe ka prezentuar

konfiskimin e pasurisë pavarsisht lidhjes kauzale të këtaj të fundit me veprën penale, i njëjti ende parasheh ekzistimin e aktgjykimit dënues si element të domosdoshëm për t'i hapur rrugë konfiskimit të pasurisë.

***Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të* Konfiskuar** hyri në fuqi në prill të vitit 2016 dhe përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Po ashtu, në Republikën e Kosovës aktualisht janë në fuqi akte tjera ligjore të cilat në një mënyrë apo në tjetrën ndërlidhen me sferën e konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme e që janë: ***Ligji Nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligji për Administratën tatimore dhe Procedurat, Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, konventat ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë****, etj.*

Së fundi, ***Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*** është dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me ndihmën e partnerëve, ku përfshihen masat që Qeveria synon të ndërmerr gjatë periudhës 2019-2023 kundër ekonomisë jo-formale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Kjo strategji synon arritjen e dy objektivave strategjike:

- Përmirësimin e cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Rritjen e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.

Në tabelën e mëposhtme identifikohen Dokumentet strategjike relevante dhe aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me çështjen që trajton ky Koncept Dokument. Poashtu precizohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre akteve si dhe roli dhe detyrat e institucioneve zbatuese të ligjit.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës (e)për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)** |
|---|---|---|---|
| KODI NR. 06/L-074<br>KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413 | Ministria e Drejtësisë<br><br>Gjykatat | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:**<br>Kur konfiskimi i pasurisë ose mjetit që është përfituar me vepër penale nuk është i mundur, Gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose Gjykata do të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlefshme. |
| KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE | [https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861) | Ministria e Drejtësisë<br><br>Gjykatat<br><br>Prokurori i shtetit | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** *Gjykatat* në bazë të KPP-së ndër të tjera shqyrtojnë kërkesat e prokurorisë për urdhërimin e sekuestrimit të përkohshëm dhe vendosin lidhur me ato kërkesa, shqyrtojnë kërkesat për lëshimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe vendosin për këto masa, shqyrton kërkesat për lëshimin e urdhrit kufizues, vendos përfundimisht lidhur me konfiskimin e pasurisë, etj.<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Ndër të tjera Prokurori i shtetit në kuadër të KPP-së është përgjegjës për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë së kundërligjshme, kufizimin e përkohshëm të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | pasurisë, mund të lëshojë urdhër për ngrirjen e përkohshme të pasurisë, përkatësisht, ndalimin e shitjes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cilitdo send i cili dyshohet se është përdorur në veprën penale nën hetim apo është fituar nga vepra penale nën hetim, kërkesën për urdhër për sekuestrim të përkohshëm, kërkesën për urdhër ndalues, përfshirjen e pasurisë së konfiskuar në aktakuzë, mund të kërkoj transferimin te Qeveria e Kosovës për shfrytëzim të automjeteve apo aeroplanëve për të cilët është bërë sekuestrimi i përhershëm etj. |
| | | Policia e Kosovës | **Zbatimi i legjislacionit:** Policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer dhe ia raporton ato prokurorit te shtetit. Zyrtarit të autorizuar të policisë mund ti delegohet mbikëqyrja dhe kontrolli i sendeve dhe pasurisë së sekuestruar përkohësisht etj. |
| LIGJI Nr. 06/L-087 PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337 | Ministria e Drejtësisë | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit** |
| | | Gjykatat | **Zbatimi i legjislacionit:** Gjykata sipas LKZKP-së ndër të tjera vendos lidhur me kërkesën për verifikim të pasurisë dhe kërkesa të tjera të prokurorit, nxjerr një urdhër kufizues përfundimtar, mban seancë dëgjimore për verifikim të pasurisë si dhe mund të vazhdojë procedurat penale dhe procedurat për konfiskimin e zgjeruar në rastet e vdekjes, mungesës, çrregullimit ose paaftësisë mendore të të pandehurit, bën konfiskimin e pasurisë së të pandehurit të fituar në mënyrë jolegjitime etj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Prokurori i shtetit | **Zbatimi i legjislacionit:** Prokurori i shtetit është i autorizuar përmes LKZKP-së të bëj kërkesën për verifikimin e pasurisë së të dënuarit, provon se pasuria e paraqitur në kërkesën për verifikim të pasurisë është pronë e të pandehurit, të lëshojë urdhër kufizues të përkohshëm që ndalon çdo person të emërtuar në urdhër që të kryejë transaksione me pasurinë e caktuar, paraqet kërkesë për urdhër kufizues përfundimtar, mund të iniciojë një hetim për konfiskim, mund të kërkojë urdhër për zbulim të informacionit, mund ti propozoj gjykatës vazhdimin e procedurën penale dhe procedurën për konfiskim etj. |
| | | Policia e Kosovës | **Zbatimi i legjislacionit:** Ekzekuton urdhrin kufizues të përkohshëm të lëshuar nga Prokurori i Shtetit, kujdeset për pasurinë dhe mirëmbanë pasurinë etj. |
| LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR | [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360) | Ministria e Drejtësisë<br><br>AAPSK | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** AAPSK ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, ekzekuton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie etj. |
| UDHËZIMI ADMINISTRATIV MD NR. 05 /2017 PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E | [https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15442](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15442) | Ministria e Drejtësisë<br><br>AAPSK | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, AAPSK mirëmbanë regjistrin e të gjitha pasurive të marra në kujdesin e saj, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| SHITJES SË PASURIVE TË LUAJTSHME TË SEKUESTRUARA | | | regjistroj njoftimin e të gjitha çështjeve të raportuara për të, merr përgjegjësinë mbi pasurinë dhe merr në pranim pasurinë, azhornon caktimin e vlerës së sendeve dhe largimin e menjëhershëm të mallrave që prishen, zhvillon procedurë të veçantë për të shitur pasurinë etj. |
| UDHËZIM ADMINISTRATIV MD/ NR.04/2017 PËR MËNYRËN E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE TË RUAJTJES DHE TË MBAJTURIT E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15317 | Ministria e Drejtësisë<br><br>AAPSK | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Bartë shpenzimet për administrimin e pasurisë së sekuestruar, ofron masa të sigurisë për sendet e sekuestruara etj. |
| RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTARË ME QËLLIM TË RRITJES SË EFIKASITETIT NË NDJEKJEN E KRYESVE TË VEPRAVE PENALE, | http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Rregulloret/2014/Nr.1511.2013-Rregullore_per_themelimin_dhe_funksionalizimin_e_Koordinatorit_Kombetare.pdf | Koordinatori Kombëtar për luftimin e krimit ekonomik | **Zbatimi i legjislacionit:** Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore; mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit; grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme; sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E DOBISË PASURORE TË FITUAR ME VEPËR PENALE | | | dhe ekonomisë jo-formale; rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion sa i përket pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit<br>ose efektivitetit të programit, etj. |
| LIGJI Nr. 04/L-050 PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË GJITHË PERSONAT ZYRTARË<br><br>Plotësuar dhe ndryshuar me LIGJIN NR. 04/L-228 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-050 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767 | AKK | **Zbatimi i legjislacionit:** Agjencia mbikëqyrë pasurinë e zyrtarit të lartë publik në bazë të informacionit të dorëzuar nga zyrtari i lartë publik, mund të kërkojë dorëzimin e këtij informacioni, mund të lejojë të marrjen e dhuratave në bazë të kërkesës, kontrollon regjistrat e dhuratave, kërkon që ndaj shkelësit të merren masa disiplinore, administron dhe mirëmban regjistrin, mund të bëjë kontrollin për saktësinë e deklarimeve, bën kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, në raste dyshimi për vepër penale pas hetimeve të kryera, ia paraqet kallëzimin penal prokurorisë kompetente etj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| LIGJI NR. 03/L-159 PËR AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662 | Qeveria<br><br><br><br>AKK | **Zbatimi i legjislacionit:** sa i përket themelimit të Agjencisë kundër Korrupsionit<br><br><br>**Zbatimi i legjislacionit** organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. |
| LIGJI Nr. 03/L-222 PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT i ndryshuar dhe plotësuar me LIGJIN NR. 04/L-115, LIGJIN NR. 04/L-102 dhe LIGJIN NR. 04/L-223 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2689 | Qeveria<br><br><br><br><br>ATK | **Zbatimi i legjislacionit:** sa i përket themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës<br><br><br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** e ngarkuar me detyrën të administrojë çdo lloj tatimi brenda territorit të vendit, dhe kompetenca tjera të përcaktuara me ligj. |
| STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKONOMISË JO-FORMALE, PASTRIMIN E PARAVE, FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE KRIMEVE | https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf | Qeveria e Republikës së Kosovës | **Hartimi i strategjisë**<br><br>**Zbatimi i strategjisë:** Qeveria merr masat kundër ekonomisë jo-formale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| FINANCIARE 2019-2023 | | | |

## 1.3 Problemi kryesor

Në këtë nën-kapitull trajtohet problemi që tageton ky Koncept Dokument njëkohësisht me shkaqet që vlerësohen se kanë ndikuar në krijimin apo edhe kanë ushqyer problemin në fjalë. Rëndësi do t'i kushtohet edhe efekteve që janë paraqitur dhe mund të vazhdojnë të paraqiten si pasojë e shkaqeve të evidentuara. Krahas tabelës në vijim, është paraqitur edhe pema e problemit që konsiston në problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij. Të njëjtat gjithashtu janë analizuar në pjesën narrative si më poshtë.

*Figura 3: Pema e problemit, shkaqet dhe efektet*

| | |
|---|---|
| ***EFEKTET*** | *1. Shifra jo të kënaqshme të realizimit të konfiskimeve* |
| | *2. Motivimi i kriminalitetit* |
| **PROBLEMI KRYESOR** | **Sistem jo efikas i konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikuar** |
| **SHKAQET** | 1. *Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit* |
| | 2. *Mangësitë e konfiskimit sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale* |
| | 3. *Mangësitë e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë* |
| | 4. *Zvarritja e proceseve gjyqësore* |
| | 5. *Aktakuza dhe aktgjykime të mangëta lidhur me konfiskimin e pasurisë* |
| | 6. *Mungesa e specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e konfiskimit* |
| | 7. *Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant* |
| | 8. *Të tjera: Ekonomia jo formale; Hezitimi i ndjekjes së personave me lidhje të fuqishme politike.* |

Nga analiza kritike e cila i është bërë legjislacionit të Kosovës për konfiskimin e pasurisë për qëllime të këtij Koncept Dokumenti, kanë dalë shqetësime serioze në lidhje me mosfunksionimin përkatësisht mungesën e efikasitetit të sistemit të sekuestrimit dhe konfiskimit e pasurisë së pajustifikueshme. Ndonëse në shikim të parë mund të fitohet përshtypja se Kosova ka vendosur bazat për një sistem të mirëfilltë të konfiskimit përmes

rishikimit të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe së fundi miratimit të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, në një analizë më të thelluar, del se në fakt sistemi i konfiskimit në vendin tonë përballet me pengesa si në aspektin e zbatimit të ligjeve ashtu edhe në aspektin e parimeve të definuara mirë e qartë lidhur me konfiskimin e pasurisë.

Infrastruktura legjislative mbi konfiskimin e pasurisë deri më tani nuk është dëshmuar e mjaftueshme për të ndërtuar një agjendë të suksesshme shtetërore në adresimin e këtij problemi. Jo vetëm kjo, mirëpo në Kosovë sot e kësaj dite mund të vërehet një mungesë e dukshme e debatit përmbajtësor në lidhje me nevojën për konfiskim të pasurisë së pajustifikueshme, sidomos kur bëhet fjalë për mbajtësit e funksioneve të larta publike.

### 1.3.1 Shkaqet

Më poshtë janë radhitur disa prej shkaqeve të cilat ndikojnë në mosefikasitetin e sistemit të konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme në Kosovë.

1. **Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit:** Konfiskimi i pasurisë së së paligjshme në Kosovë rregullohet përmes tre shtyllave legjislative: Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Nga diskutimet e zhvillluara me anëtarë të grupit punues është potencuar se jo rrallë herë ndodhë që organet e ndjekjes të mos e kenë të qartë se kur duhet të zbatohet logjika e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës e kur ajo e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Ky konfuzitet është prezent sidomos sa i përket ndërlidhjes së procedurave të normuara me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe ato që parashihen sipas Kodit të Procedurës Penale. Kjo për faktin se hartimi i ligjit dhe hyrja në fuqi e tij ishte menduar të bëhej paralel me Kodin e ri të Procedurës Penale, i cili ende konsiston vetëm në një draft, andaj edhe nuk ka harmonizim të plotë dhe rrjedhshmëri në mes Kodit ekzistues të Procedurës Penale dhe Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Veç kësaj, fakti që legjislacioni aktual i Kosovës në fushën e konfiskimit karakterizohet në një masë nga gjuha e pa njësuar (përdorimi i një mori termash të cilët i referohen të njëjtit insitut ligjor - sekuestrim", "sekuestrim i përkohshëm" dhe "konfiskim i përkohshëm") i kontribuon edhe më tutje këtij problemi.

2. **Mangësitë e konfiskimit sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale:** Konfiskimi tradicional penal i rregulluar me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës

Penale të Republikës së Kosovës nuk i pajisë autoritetet zbatuese të ligjit me mjete të nevojshme dhe efektive për konfiskimin e një përqindjeje të kënaqshme të pasurisë së fituar përmes veprave penale dhe asaj të përdorur për kryerjen e veprave penale. Janë disa arsye që dërgojnë në një konkluzion të tillë. Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës lejojnë konfiskimin e pasurisë vetëm në prani të aktgjykimit dënues. Kjo nënkupton se përderisa një person të mos jetë dënuar me aktgjykim dënues për kryerjen e veprës penale, pasuria e tij nuk mund të konfiskohet edhe në ato raste kur ka dyshime të bazuara se e njëjta nuk ka origjinë legjitime. Një situatë e tillë në praktikë shkakton vështirësi të shumta për faktin se nxjerrja e një aktgjykimi dënues jo gjithmonë është i mundur. Ka raste kur për shkak të mungesës së provave, parashkrimit të veprës penale, imunitetit të kryesit të veprës penale, vdekjes, sëmundjes apo zhdukjes së tij, procedura penale ose nuk mund të inicohet fare, ose nuk mund të rezultojë me aktgjykim dënues. Rrjedhimisht, në mungesë të këtij aktgjykimi, nuk mund të hapet terreni për zhvillimin e procedurës konfiskuese. Krahas kësaj, sipas Kodit të Procedurës Penale, Prokurori i Shtetit duhet të provojë në shqyrtim gjyqësor se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti kanë qenë dobi pasurore e veprës penale në hetim apo janë përdorur për kryerjen e veprës penale në hetim. Një përcaktim i tillë, sipas anëtarëve të grupit punues, vë barrë mjaft të rëndë mbi prokurorinë për faktin se ligjërisht është shumë e vështirë që të vërtetohet lidhja shkak-pasojë e cila nevojitet për të dëshmuar se me një vepër të caktuar penale është fituar një pasuri e caktuar apo se pasuria në fjalë është përdorur për kryerjen e veprës penale. Vërtetimi i lidhjes së pasurisë me veprën penale është posaçërisht i vështirë kur bëhet fjalë për grupet e sofistikuara kriminale të cilat kanë resurse dhe përvojë të bollshme për t'i fshehur gjurmët e veprave të tyre penale dhe pasurinë e fituar përmes tyre. Pasojat e një barre të tillë të provës vërehen në numrat e vegjël të konfiskimeve përfundimtare.

3. **<u>Mangësitë e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë:</u>** Qysh në fillim vlen të theksohet se është e vështirë që të identifkohen mangësitë e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë duke marrë parasysh faktin që edhe pas kalimit të më shumë se një viti prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, ekziston vetëm një një rast i identifikuar i zbatimit të tij në praktikë. Njëkohësisht, për ligjin në fjalë nuk ekziston ndonjë vlerësim *ex post* i cili do të demonstronte të mirat apo të metat e ligjit. Kjo implikon që problemi themelor në këtë drejtim, më shumë sesa në mangësi konkrete legjislative, qëndron në implemetimin e tij. Në fakt, duhet të potencohet që Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë në masë të madhe adreson të metat e konfiskimit tradicional penal sipas

Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kjo për faktin se ky ligj shkon përtej konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe asaj të përdorur për kryerjen e veprës penale, duke mundësuar kështu konfiskimin e çfarëdo pasurie të personit të dënuar, origjinën legjitime të së cilës ky i fundit nuk arrin të dëshmojë. Pra, barra dikur e rëndë për prokurorinë, tani bartet tek i akuzuari i cili duhet të dëshmojë origjinën e ligjshme të pasurisë së tij. Megjithatë, përkundër lehtësimeve lidhur me barrën e provës që ka sjellur ky ligj, shqetësim prevalent sërish mbetet kërkesa për akgjykim dënues si *conditio sine qua non* për realizimin e konfiskimit të pasurisë. Siç është elaboruar më lartë, rruga deri në arritjen e një aktgjykimi dënues për kryerjen e veprave penale është komplekse dhe kërkesa e aktgjykimin dënues, pa kurrfarë përjashtimi, si kusht i domosdoshëm për konfiskim, ndikon negativisht në efikasitetin e sistemit të konfiskimit dhe në luftimin e suksesshëm të kriminalitetit në përgjithësi. Veç kësaj, janë dy çështje të tjera të cilat, pas zbatimit të këtij ligji në praktikë, mund të rezultojnë problematike. Së pari, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë lejon vetëm konfiskimin e pasurisë që i pandehuri e ka fituar brenda dhjetë (10) viteve para ditës kur është inicuar faza hetimore për veprat penale të parapara me ligjin në fjalë, duke mundësuar kështu amnistim për pasurinë e fitur qoftë edhe një ditë të vetme para kësaj date. Megjithatë, duke marrë parasysh ndryshimet politike dhe shoqërore nëpër të cilat ka kaluar Kosova qysh nga mesi i vitit 1999 dhe viti 2000, nuk do të ishte gabim të supozohet se themelet për pasurimet më të mëdha të paligjshme të grupeve të caktuara kriminale, janë vendosur pikërisht gjatë kësaj kohe. Ndaj, kufizimi prej dhjetë (10) viteve që ky ligj vendosë, mund të rezultojë problematik në luftimin e suksesshëm të kriminalitetit. Së dyti, konfiskimi i zgjeruar sipas Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë mund të zbatohet vetëm për pasurinë e personave të dënuar për veprat penale të numëruara taksativisht me këtë ligj, e që pëfshinë një numër të veprave të rënda penale dhe ato që kanë rezultuar me dobi pasurore mbi 10.000 Euro. Kjo nënkupton, që për veprat e tjera penale, do të vlejnë parimet e konfiskimit tradicional sipas të cilave mund të konfiskohet vetëm pasuria e cila është dobi pasurore e krimit apo ajo e cila është e përdorur për të kryer krimin, e jo edhe pasuria të cilën i pandehuri nuk mund ta justifikojë. Pra, ndonëse avantazhet të cilat i sjellë konfiskimi i zgjeruar janë të pamohueshme, problemi megjithatë qëndron në fushëveprimin e tij të kufizuar.

4. **Zvarritja e proceseve gjyqësore:** Zvarritja e proceseve gjyqësore është faktor që ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në numrat e vegjël të konfiskimit. Përpos deklarimit verbal, nuk ka ndodhur deri tani që rastet që kanë të bëjnë me konfiskim të trajtohen me prioritet nga ana e gjykatave. Kështu, si rezultat i zvarritjeve në procedurë mund

të vie deri tek parashkrimi i veprës penale dhe si rrjedhojë humbja e mundësisë për konfiskim. Po ashtu, zvarritja e procedurave për një kohë të gjatë mund të ketë si efekt që pasuria e sekuestruar jo vetëm të humbë vlerën, por edhe të kthehet në barrë për shtetin. Përderisa është e vërtetë që sipas Ligjit për Admnistrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Prokurori i Shtetit apo organi tjetër kometent mund të kërkojë nga gjykata të vendosë për shitjen e një pasurie që mund ta humbë vlerën ose në rast të magazinimit të saj e tejkalon vlerën e saj, apo kur shpenzimet e magazinimit janë joproporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar, në praktikë vërehet dukshëm hezitimi i gjykatave për të lejuar një shitje të tillë. Veç kësaj, ka edhe raste të tilla kur prokuroria gabimisht cilëson pasurinë e personit të akuzuar si provë duke pamundësuar kësisoji lejimin e shitjes së saj. E gjithë kjo pengon efikasitetin e konfiskimit të pasurisë dhe luftimin e duhur të kriminalitetit.

5. **<u>Aktakuza dhe aktgjykime të mangëta lidhur me konfiskimin e pasurisë:</u>** Numrave të ulët të konfiskimeve i kontribuon në masë të madhe edhe cilësia jo e kënaqshme e hartimit të aktakuzave nga ana e prokurorisë dhe aktgjykimeve nga ana e gjykatës. Sa i përket aktakuzave të përpiluara nga prokuroria, në praktikë vërehen dy probleme kryesore: mospërfshirja në aktakuzë e pasurive që mund të jenë objekt i konfiskimit dhe mos arsyetimi i nevojës për konfiskim. Lidhur me të parën, mospërfshirja në aktakuzë e pasurive që mund të jenë objekt i konfiskimit shkon kundër synimit për luftimin efektiv të kriminalitetit. Kjo për faktin se sipas legjislacionit tonë, gjykata mund të urdhërojë konfiskim vetëm për ato pasuri të cilat janë paraparë taksativisht në aktakuzë. Lidhur me të dytën, nuk janë të rralla rastet kur prokurorët mjaftohen vetëm me përcaktimin e pasurive për konfiskim në dispozitivin e aktakuzës, duke mos elaboruar fare dyshimin e bazuar se pasuria në fjalë është rrjedhojë e veprës penale nën hetim, është përdorur për kryerjen e saj, ose ka pasur qëllim të përdoret në kryerjen e veprës penale. Kujtojmë që përderisa identifikimi i pasurisë së të pandehurit është i mjaftueshëm kur bëhet fjalë për konfiskimin e zgjeruar, një gjë e tillë nuk mjafton edhe për konfiskimin tradicional penal sipas kornizës së Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Së fundi, mungesa e arsyetimit lidhur me konfiskimin është mangësi edhe e gjykatës me rastin e përpilimit të aktgjykimeve. Në të shumtën e rasteve, gjyqtarët në aktgjykime, si kur konfiskohet ashtu edhe kur refuzohet konfiskimi, elaborojnë minimalisht arsyet që kanë dërguar në konfiskim apo refuzimin e tij, përkundër faktit që sipas Kodit të Procedurës Penale ata duhet të arsyetojnë konfiskimin e secilës pasuri veç a veç. Mungesa e një arsyetimi të tillë, ka implikime me rastin e apelimit të aktgjykimit në shkallën e dytë.

6. **Mungesa e specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e konfiskimit:** Rrënja e një sërë problemeve të cilat ndërlidhen me mos efikasitetin e sistemit të konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme në Kosovë, mund të gjendet në mungesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar në fushën e konfiskimit të pasurisë. Deri më tani, as në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e as Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk ka gjyqtarë dhe prokurorë të specializuar të cilët merren posaçërisht me rastet e konfiskimit dhe të cilët trajnohen vazhdimisht në këtë fushë. Përderisa gjatë viteve të kaluara institutet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë kanë ofruar një sërë trajnimesh me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale në sferën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe rrjedhimisht edhe konfiskimit të pasurisë, pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këto trajnime nuk ka qenë konsistente. Gjegjësisht, zgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë ndjekur këto trajnime është bërë në mënyrë të rëndomtë dhe duke mos u bazuar në ndonjë kriter të caktuar, në vend të përzgjedhjes së një numri të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët do të ndjeknin këto trajnime në baza të rregullta dhe të cilët pastaj do të ngarkoheshin me rastet e konfiskimit të pasurisë duke marrë parasysh specializimin e tyre.

7. **Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant:** Konfiskimi është çështje mjaft komplekse si për nga dinamika ashtu edhe për nga kohëzgjatja. Për këtë arsye, për të siguruar mirëfunksionim të konfiskimit në përgjithësi, koordinimi i mirëfillët ndër-institucional është esencial. Ky koordinim ndër-institucional është posaçërisht i rëndësishëm në stadin e hetimeve dhe procedurës paraprake kur Prokurori i Shtetit duhet të ketë bashkëpunim të intensifikuar me organet e specializuara shtetërore si NJIF, Dogana e Kosovës, ATK dhe AKK me qëllim të arsyetimit sa më të fuqishëm të aktakuzës. Poashtu, koordinimi duhet të vazhdojë edhe pas sekuestrimit të pasurisë, këtu sidomos në mes të prokurorisë, Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe në një masë edhe gjykatës, me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese për evitimin e humbjes së vlerës së pasurive të sekuestruara. Diskutimet me anëtarët e grupit punues kanë treguar mungesë të një koordinimi të tillë ndër-institucional në mes të akterëve relevant, gjë kjo e cila reflektohet në mungesën e mirëfunksionimit të sistemit të konfiskimit në vend.

8. **Të tjera:** Janë evidentuar edhe shkaktarë të natyrës sociale dhe ekonomike që shpien gjerë në funksionimin jo të kënaqshëm të konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustfikueshme. Ndonëse këto shkaqe vështirë se mund të adresohen me opsionet e propozuara të këtij Koncept Dokumenti, për shkak të rëndësisë së tyre shumë dimensionale, nuk mund të anashkalohen. Këtu bëhet fjalë për:

**(i) Ekonominë jo-formale:** Ekonomia jo-formale paraqet shkak mjaft krucial për vështirësitë në të provuarit e pronësisë mbi pasurinë që supozohet të jetë e lidhur me vepër penale. Për shkak të informalitetit sa i përket pasurisë së trashëguar, kontratave të shitblerjes dhe remitancave të diasporës, vërtetimi i prejardhjes së pasurisë është i vështirë si për organet ndjekëse kur bëhet fjalë për konfiskimin tradicional penal, ashtu edhe për të pandehurin kur bëhet fjalë për konfiskimin e zgjeruar.

**(ii) Hezitimin e ndjekjes së personave me lidhje të fuqishme politike:** Një numër të raporteve të organizatave të shoqërisë civile në vend është gjetur se Prokurori i Shtetit ka injoruar rastet ku mundësia për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale është shumë e madhe. Këto raporte theksojnë se Prokurori i Shtetit gjatë shenjëstrimit të rasteve të rënda, anashkalon persona të cilët vijnë nga politika apo kanë lidhje të fuqishme politike përkundër natyrës së rëndë të veprave penale për të cilat akuzohen.

### 1.3.2 Efektet

Në kuadër të asaj që u tha më sipër, shkaqet e problemit kryesor kanë ndikuar në paraqitjen e dy efekteve negative thelbësore sa i përket konfiskimit të pasurisë joligjore: shifra jo të kënaqshme të konfiskimeve dhe motivim të kriminalitetit.

Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit të konfiskimit në vend, mangësitë e shtyllës legjislative të konfiskimit, mungesa e koordinimit ndër-institucional, mungesa e specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e konfiskimit, arsyetimi i dobët i aktakuzave dhe aktgjykimeve lidhur më konfiskimin, zvarritja e proceseve gjyqësore, ekonomia jo-formale dhe hezitim i ndjekjes të personave me lidhje të fuqishme politike, ndikojnë drejtëpërsëdrejti në mos efikasitetin e sistemi të konfiskimit në vend duke rezultuar kështu me numra të vegjël të konfiskimeve përfundimtare. Të njëjtat probleme, njëkohësisht, pamundësojnë luftimin e sukseshshëm të kriminalitetit në vend duke motivuar kësisoji kryesit potencial të veprave penale për gjenerimin e mëtutjeshëm të të mirave materiale përmes veprimtarive të tyre të paligshme duke ditur se gjasat për konfiskim, marrë parasysh problemet e rrënjosura sistemin aktual të konfiskimit, janë të vogla. Kështu, shteti dështon në parandalimin dhe pengimin e funksionimit të grupeve kriminale por edhe kryesëve individual dhe, si rrjedhojë, thellohet humbja e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

## 1.4 Palët e interesit në bazë të përkufizimit të problemit

Në tabelën e mëposhtme listohen palët e interesit. Gjithashtu tregohet nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje sqaron se si ato janë të lidhura me shkaqet apo efektet e potencuara.

*Figura 2: Pasqyrim i palëve të interesit në lidhje me përkufizimin e problemit*

| ***Emri i palës së interesuar*** | ***Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala*** | ***Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)*** |
|---|---|---|
| Ministria e Drejtësisë | 1. Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit;<br>2. Mangësitë e konfiskimit sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale;<br>3. Mangësitë e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. | Hartues i politikave për konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të pajustifikueshme. |
| Këshilli Gjyqësor i Kosovës | 1. Zvarritja e proceseve gjyqësore;<br>2. Aktgjykime të mangëta lidhur me konfiskimin e pasurisë;<br>3. Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Është administrues i drejtësisë në vend. Zbaton politikat e hartuara në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore. |
| Këshilli Prokurorial i Kosovës | 1. Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant;<br>2. Aktakuza të mangëta lidhur me konfiskimin e pasurisë;<br>3. Zvarritja e proceseve gjyqësore;<br>4. Hezitimi i ndjekjes së personave me lidhje të fuqishme politike. | Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive. Zbaton politikat e hartuara në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Prokurori i shtetit | 1. Aktakuza të mangëta lidhur me konfiskimin e pasurisë;<br>2. Zvarritja e proceseve gjyqësore;<br>3. Hezitimi i ndjekjes së personave me lidhje të fuqishme politike;<br>4. Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant;<br>5. Mangësitë e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë;<br>6. Mangësitë e konfiskimit sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. | Institucion zbatues i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë. Kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj |
| Policia e Kosovës-Departamenti i hetimeve | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Departamenti i Hetimeve në kuadër të Policisë së Kosovës kontribuon në parandalimin e kriminalitetit, zbulimi dhe hetimi i kryerësve të veprave penale. |
| Akademia e Drejtësisë | Mungesa e specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e konfiskimit. | Përgjegjëse për ngritjen e profesionalizmit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës. Zhvillon trajnime specifike në përputhje me nevojat e politikave. |
| AAPSK | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale. Mbanë evidencat për pasurinë të cilën e administron dhe për vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar. |

| | | |
|---|---|---|
| Agjencia kundër Korrupsionit | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Mbikëqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë. |
| Dogana e Republikës së Kosovës | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit Doganor. Ka kapacitet për të kontribuar në zbulimin e mashtrime serioze dhe kontrabandës e krimit të organizuar. |
| Administrata Tatimore e Kosovës | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Autoritet ekzekutiv i cili funksion me autonomi të plotë operacionale me detyrën të administrojë çdo lloj tatimi në Republikën e Kosovës. Ka kapacitet për të kontribuar në zbulimin e mashtrime serioze në vend dhe pasurisë së pajustifikueshme. |
| Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës | Mungesa e koordinimit mes akterëve relevant. | Institucioni qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit. Ka kapacitet për të kontribuar në parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe luftimin e financimit të terrorizmit. |

# Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat të cilat adresohen me këtë Koncept Dokument janë përcaktuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020 – 2023 por edhe janë saktësuar në mënyrë specifike për qëllime të këtij Koncept Dokumenti, si më poshtë.

*Figura 3.: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Objektiva relevante** | **Emri i dokumentit planifikues relevant** |
|---|---|
| *Objektivi strategjik* 2, Sundimi i Ligjit | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020 – 2023. |
| *Objektivi specifik:* Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit | Ky objektiv është saktësuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti. |

# Kapitulli 3: Opsionet

Ky Koncept Dokument ka trajtuar të gjitha opsionet me të cilat mund të procedohet në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme. Siç është potencuar edhe më lartë, kjo është bërë me qëllim që produkti i cili del nga ky Koncept Dokument, të jetë sa më i përafërt me standardet bashkëkohore ndërkombëtare të kësaj fushe dhe rrjedhimisht të përmirësojë gjendjen në vend.

Së këndejmi, Koncept Dokumenti trajton tre opsione kryesore: opsioni *status quo (pa asnjë ndryshim)* sipas të cilit situata aktuale dhe si pasojë vështirësitë e paraqitura në praktikë, do të vazhdojnë së ekzistuari; opsioni i *përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative*, opsion ky i cili ndonëse me potencial të adresojë disa prej problemeve të identifikuara në këtë Koncept Dokument, e ka të pamundur të ofrojë bazë të re ligjore mbi të cilën do të lejohej konfiskimi i pasurisë edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues; dhe së fundi opsioni me *ndryshime legjislative* i cili parasheh hartimin e ligjit të ri për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme përmes të cilit synohet të futet në zbatim konfiskimi me bazë civile.

## 3.1: Opsioni status quo (pa asnjë ndryshim)

Opsioni i parë *status quo (pa asnjë ndryshim)* parasheh vazhdimin e gjendjes aktuale në fushën e konfiskimit të pasurisë. Sipas këtij opsioni, konfiskimi i pasurisë së fituar me origjinë joligjore do të vazhdojë të mbështetet në tre shtyllat ekzistuese legjislative,

gjegjësisht Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Kjo nënkupton se problemet të cilat veçse kanë ekzistuar deri më tani në këtë drejtim, me shumë gjasë do të vazhdojnë të mbeten të njëjta, apo në skenarin më të keq, do të intensifikohen edhe më shumë për disa arsye.

Së pari, sikurse të zgjedhet ky opsion, preferenca e organeve ndjekëse për konfiskim tradicional penal do të vazhdojë të jetë prevalente dhe rrjedhimisht elementi kyç për konfiskimin e pasurisë së paligjshme do të vazhdojë të mbetet ekzistimi i aktgjykimit dënues. Kjo përkundër faktit se përvoja e deritanishme ka dëshmuar se kjo formë e konfiskimit të pasurisë nuk po jep frytet e dëshiruara. Raporti mbi aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për vitin 2019 tregon se numri i konfiskimeve përfundimtare të realizuara duke u mbështetur në dispozitat ekzistuese është shumë i vogël. Përderisa në vitin 2019 kemi pasur ngrirje apo sekuestrim të pasurisë që kap shumën prej rreth 8.800.000 €, vlera e pasurisë së konfiskuar në të njëjtin vit rrumbullaksohet në vetëm 1.000.000 € dhe kjo nga një rast i vetëm i konfiskimit të suksesshëm. Me ruajtjen e *status quo*, numri i konfiskimeve me shumë gjasë do të vazhdojë të mbetet i vogël dhe krahas kësaj do të shfaqet rreziku që kryesit e veprave penale të motivohen edhe më shumë për gjenerimin e të mirave materiale përmes aktiviteteve të tyre joligjore duke marrë parasysh problemet të cilat janë të rrënjosura në sistemin aktual të konfiskimit.

Se situata aktuale në fushën e konfiskimit të pasurisë me origjinë jo legjitime nuk është e kënaqshme është theksuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Vendin të vitit 2019. Në këtë Raport, Komisioni Evropian ka nënvizuar se Kosova ka arritur progres shumë të vogël në fushën e konfiskimeve përfundimtare të pasurisë dhe e njëjta duhet të ndërmerr masa për të siguruar në mënyrë rigoroze se nuk ka ndërhyrje politike me aktivitetet operative të organeve të zbatimit të ligjit dhe të prokurorisë. Sikurse të zgjedhet opsioni *status quo*, rekomandimet e dhëna nga ana e Komisionit Evropian në kuadër të Raportit për Vendin të vitit 2019 nuk do të adresohen, duke stagnuar kësisoji procesin integrues të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Së dyti, trendi gjithmonë në rritje në fushën e konfiskimit të pasurisë së paligjshme kërkon vendosjen e indikatorëve nxitës apo indicieve të caktuara të cilat justifikojnë inicimin e procesit të konfiskimit edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues. Në këtë drejtim, nuk janë të rralla rastet kur stili i jetesës së personave të caktuar nuk korrespondon me të ardhurat e deklaruara dhe ndonëse ekziston dyshimi se pasuria e pajustifikueshme e këtyre personave ka prejardhje joligjore, e njëjta nuk mund të konfiskohet pasi që sipas kornizës aktuale ligjore, procedura konfiskuese e pasurisë është domosdoshmërisht e

lidhur me ekzistimin e aktgjykimit dënues. Ndaj, nëse ruhet *status quo*, pra nëse sistemi i konfiskimit në Kosovë vazhdon të bazohet vetëm në procedurën penale që rezulton me aktgjykim dënues, atëherë asnjë indikatorë nxitës apo indicie nuk mund të merret si e qenë përderisa bartësit e tyre të mos jenë dënuar për kryerjen e një vepre penale paraprakisht. Si rrjedhojë, me ruajtjen e *status quo,* sistemi i konfiskimit në vend nuk do t'i bashkëngjitet trendit në rritje i cili lejon konfiskimin e pasurisë në mungesë të aktgjykimit dënues.

Së fundi, problematikë thelbësore është edhe mungesa e prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar të cilët merren me rastet e konfiskimit së pasurisë jo ligjore. Në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkesa për verifikimin e pasurisë së personit të dënuar me kryerjen e veprës penale bëhet nga Prokurori i Shtetit dhe e njëjta shqyrtohet prej gjykatës e cila ka nxjerrë aktgjykimin. Përderisa puna e Prokurorit të Shtetit është deri diku më e specializuar duke marrë parasysh bashkëpunimin e këtij të fundit me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Njësinë për Inteligjencë Financiare, shqetësimi është më relevant sidomos në rastin e gjyqtarëve të cilët gjykojnë raste të natyrave të ndryshme pa ndonjë specializim të veçantë. Zgjedhja e këtij opsioni, nuk do të adresojë këtë problematikë.

### 3.2: Opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative

Opsioni i dytë shqyrton mundësinë e përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime konkrete legjislative. Ky opsion, ngjashëm me opsionin e parë, do ta mbante Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë si shtylla themelore për sistemin e konfiskimit në vend, ndonëse me disa ndryshime sistematike të cilat synojnë të përmirësojnë zbatimin e tyre.

Siç është përmendur më lartë në kuadër të kapitullit për problemin kryesor, tre shtyllat legjislative që rregullojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë në Kosovë nuk janë mirë të harmonizuara duke shkaktuar kësisoj huti në lidhje me frymën e përgjithshme të sistemit. Si pasojë, shpesh herë është e paqartë se kur duhet të operohet logjika e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale apo Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Për më tepër, fakti që ekziston vetëm një rast i identifikuar i zbatimit të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë e forcon edhe më tepër argumentin se organet e ndjekjes nuk e kanë të qartë se kur duhet të zbatohet ky akt dhe çfarë ndryshimesh i sjellë ky i fundit bazës konfiskuese veçse të vendosur me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Sa i përket gjykatave, nuk mund të vlerësohet se si qëndrojnë ato me të kuptuarit sa i përket aplikimit të LKZKP-së

duke marrë parasysh se deri sot është paraqitur vetëm një kërkesë në gjykatë për procedim sipas këtij ligji.

Opsioni për përmirësimin e zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative synon të adresojë këtë problem përmes ofrimit të trajnimeve të posaçme si për prokurorët ashtu edhe për gjyqtarët në fushën e konfiskimit të pasurisë. Fokusi i trajnimeve, sipas këtij opsioni, do të orientohet sidomos drejt gjyqtarëve ngase të njëjtit kanë qenë më pak të përfshirë në trajnime dhe takime sa i përket legjislacionit për konfiskimin e pasurisë. Opsioni në fjalë synon të sigurojë trajnim konsistent të gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim që pikërisht ata gjyqtarë dhe prokurorë të cilët specializuar të merren pastaj me rastet e konfiskimit, në vend të specializimit të një grupi gjyqtarësh e prokurorësh e pastaj ngarkimit të një grupi tjetër me procedurat konfiskuese. Kështu, përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të organeve të cilat merren me konfiskimin e pasurisë, ky opsion ka synim përfundimtar që të përmirësoj zbatimin e gjithmbarshëm të kornizës ligjore në vend.

Po ashtu përmes kësaj politike, fokus i veçantë do t'i kushtohet ngritjes së nivelit të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve zbatuese përmes tryezave të punës, konferencave të përbashkëta, diskutimeve ndërmjet të gjitha palëve të interesit dhe akterëve të tjerë relevantë.

Opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative parasheh edhe rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë të specializuar në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Megjithatë, duke marrë parasysh se obligimi për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë ka ekzistuar tash e sa kohë dhe nuk është realizuar, gjasat që të realizohet tani nuk duken të jenë shpresëdhënëse.

Përkundër këtyre, vlen të vihet në pah se ky opsion, përkundër disa efekteve pozitive që mund t'i sjellë, do të vazhdojë të mos e adresojë të metën kryesore të sistemit. Më fjalë të tjera, përkundër përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore, ky opsion nuk do të hapë rrugën për realizimin e konfiskimit me bazë civile. Kjo për faktin se as Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës e as Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë nuk mundësojnë konfiskimin e pasurisë përmes procedurës civile dhe në mungesë të aktgjykimit dënues.

Ndaj, si konkluzion, mund të thuhet se opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative mund të rezultojë i pamjaftueshëm për të përmirësuar gjendjen aktuale në vend dhe për të bërë eliminimin e problemeve kryesore të

cilat janë identifikuar më lartë. Kjo për faktin se këto probleme, përveç se kanë të bëjnë me moszbatimin e duhur të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, janë të lidhura edhe me mangësitë ligjore të këtyre akteve në fushën e lejimit të konfiskimit në mungesë të një aktgjykimi dënues.

### 3.3 Opsioni i miratimit të ligjit të ri i cili mundëson realizimin e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues

Opsioni i tretë do të shqyrtojë mundësinë e ndryshimeve ligjore përmes miratimit të një ligji të ri i cili parasheh konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme në procedurë civile. Kjo do bëhej krahas prezantimit të një standardi më të ulët të të provuarit sa i përket konfiskimit të pasurisë pa aktgjykim dënues.

Qysh në fillim vlen të theksohet se sikurse të adoptohet opsioni i tretë dhe të procedohet me miratimin e një ligji të ri i cili mundëson konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme në mungesë të një aktgjykimi dënues, Kosova nuk do të jetë shteti i parë as në rajon e lërë më në Evropë që ndërmerr një veprim të tillë. Në anën tjetër, sa i përket dilemave se a duhet të shfuqizohet LKZKP me miratimin e ligjit në fjalë, theksohet se këto dy ligje do të vepronin ndaras dhe paralel me njëri tjetrin. Kjo pasi që konfiskimi civil do të shërbej si mjet i fundit dhe nuk do përvetësojë, në parim, primatin e konfiskimit tradicional penal.

Prej hulumtimit të bërë për qëllime të këtij Koncept Dokumenti janë gjetur dy modele të konfiskimit civil prej të cilave Kosova mund të merr inspirim gjatë hartimit të ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme.

*Modeli i parë i konfiskimit civil* targeton pasurinë me origjinë të paligjshme, model ky i njohur në zhargonin juridik si konfiskimi *in rem*. Sipas këtij modeli, në rastet kur prokurori apo organet e tjera të autorizuara kanë dyshime se pasuria e personave të caktuar është fituar përmes veprimtarisë joligjore, atëherë ata mund të bëjnë kërkesë për konfiskimin e pasurisë edhe në rastet kur ndaj personave të tillë nuk ekziston një aktgjykim dënues. Pra, sipas këtij modeli lejohet konfiskimi i pasurisë me origjinë joligjore edhe pse nuk është dëshmuar paraprakisht se është kryer vepra penale përmes së cilës është përfituar pasuria në fjalë. Fushëveprimi i këtij modeli, në parim, shtrihet mbi të gjithë qytetarët, pa kufizime në kategori të caktuara.

*Modeli i dytë i konfiskimit civil* bënë krahasimin e pasurisë aktuale të personave të caktuar me të ardhurat e deklaruara me qëllim të identifikimit të diskrepancës mes tyre. Edhe për këtë model konfiskimi, vërtetimi se pasuria e pajustifikueshme është fituar përmes kryerjes së veprës penale nuk është i nevojshëm për t'i hapur rrugën konfiskimit civil.

Në pjesën në vijim, Koncept Dokumenti do të jep shembuj të shteteve të cilat kanë adoptuar modelet në fjalë.

Modeli i parë i konfiskimit, apo ai *in rem,* është përqafuar nga një numër i madh i shteteve në Evropë. **Irlanda** konsiderohet si njëra prej storieve më të suksesshme në këtë drejtim. Qysh prej njohjes së konfiskimit civil në verën e vitit 1996, shteti irlandez morri pozitën prijëse në kapjen e pasurisë së paligjshme në mungesë të aktgjykimit dënues. Konfiskimi civil në Irlandë rregullohet përmes Aktit mbi të Ardhurat e Krimit (Proceeds of Crime Act). Ky akt mbulon të gjitha ato pasuri të cilat në një mënyrë apo në një tjetër janë të lidhura me sjelljet kriminale të personave të caktuar. Procedura e paraparë përmes këtij akti ligjor operon jashtë sistemit konvencional të drejtësisë penale. Kjo nënkupton se përmes tij nuk kërkohet që një person të jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale në mënyrë që fillohet procedura për konfiskimin e pasurisë. Në fakt, jo vetëm që nuk kërkohet një aktgjykim dënues mirëpo nuk është i nevojshëm as edhe inicimi i procedurës penale. Me fjalë të tjera, Akti mbi të Ardhurat e Krimit vepron tërësisht në sferën civile.

Sipas këtij akti ligjor, gjykata pas kërkesës së zyrtarëve të autorizuar, mund të urdhërojë fillimisht sekuestrimin e pastaj edhe konfiskimin përfundimtar të pasurisë nëse plotësohen tre kushte: dyshohet se pasuria është përfituar përmes veprës penale, dyshohet se pasuria është e lidhur në një mënyrë apo në një tjetër me pasurinë e përfituar me vepër penale dhe vlera e kësaj pasurie nuk është më e vogël se pesë mijë funta. Meqë procedura në fjalë në thelb është e natyrës civile, edhe standardi i provës është i tillë. Pasi që gjykata të ketë miratuar kërkesën e zyrtarëve të autorizuar për sekuestrimin e pasurisë, barra e provës bartet tek i dyshuari i cili pastaj duhet të dëshmojë se pasuria e tij ka origjinë legjitime. Nëse i dyshuari dështon të bëjë një gjë të tillë, atëherë pasuria e tij konfiskohet përfundimisht dhe e njëjta bartet në pronë të shtetit.

Ngjashëm me Irlandën, edhe **Mbretëria e Bashkuar** njeh konfiskimin civil të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme. Pjesa e pestë e Aktit mbi të Ardhurat e Krimit i vitit 2002 përbënë bazën ligjore të konfiskimit civil e cila mbulon të ashtuquajturën 'pronë të rikuperueshme' dhe 'paratë e gatshme'. 'Prona e rikuperueshme' në kuptim të këtij Akti mbulon të gjitha të ardhurat direkte të krimit, qofshin këto të të konvertuara apo jo. Vlen të theksohet se përkufizimi i pronës për qëllime të konfiskimit civil është qëllimisht i gjerë dhe përfshinë (a) para; (b) të gjitha format e pasurisë, reale ose personale, të trashëgueshme

ose të luajtshme; dhe (c) gjëra në veprim dhe pronë tjetër jo-materiale ose jo të prekshme. 'Paratë e gatshme' në anën tjetër përfshijnë jo vetëm banknotat dhe monedhat, por edhe çeqet.

Modeli i konfiskimit civil i cili aplikohet në Mbretërinë e Bashkuar karakterizohet me dy tipare thelbësore: së pari, modeli i procedurës *in rem* targeton pasurinë që besohet të jetë produkt i krimit dhe jo personin i cili mund edhe të mos hetohet fare; dhe së dyti, meqë ky model i konfiskimit ka bazë civile, atëherë edhe standardi i provës është i njëjtë sikurse në procedurën civile- *'balanci i probabiliteteve'* e jo standardi *'përtej dyshimit të arsyeshëm'* i cili zbatohet në procedurën penale.

Me pak fjalë, procedura e konfiskimit civil në Mbretërinë e Bashkuar mund të inicohet prej njërës prej autoriteteve të autorizuara me Aktin mbi të Ardhurat e Krimit (Prokuroria, Zyra për Mashtrimet e Rënda dhe Agjencia për Krime të Rënda) e cila mund të paraqes kërkesë para Gjykatës së Lartë për konfiskimin e 'pronës së rikuperueshme' apo 'parave të gatshme' kur dyshohet që këto të fundit kanë origjinë joligjore.

Barra e të provuarit se pasuria në fjalë me të vërtetë është fituar përmes veprimtarisë së kundërligjshme nuk transferohet tek personi i dyshuar, meqë siç u tha më lartë, procedura e konfiskimit civil targeton pasurinë me origjinë joligjore, e jo personin. Duke qenë se standardi i provës është *'balancit të probabiliteteve'*, krejt çfarë autoritetet e autorizuara duhet të bëjnë është të argumentojë se *është më e mundur sesa jo* që pasuria ka origjinë joligjore, në mënyrë që Gjykata e Lartë të aprovojë kërkesën e tyre për konfiskim.

Tutje, krahas Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, edhe **Sllovenia** adopton modelin e parë të konfiskimit civil. Në fakt, rasti i Sllovenisë është relevant për Kosovën duke marrë parasysh sfidat e ngjashme në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend. Konfiskimi civil në Slloveni rregullohet përmes Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë me Origjinë të Paligjshme. Sllovenia me nxjerrjen e këtij ligji në vitin 2011, vendosi për qëllim parandalimin e fitimit dhe përdorimit të pasurisë me origjinë të paligjshme përmes konfiskimit të pasurisë me origjinë të paligjshme drejtpërdrejt nga pronarët e këtyre pasurive, apo me rastin e transferimit të saj, përmes konfiskimit të pasurisë së fituar falas apo me kompensim i cili nuk korrespondon me vlerën aktuale të pasurisë.

Konfiskimi i pasurive të tilla me origjinë të paligjshme në Slloveni nuk varet nga ekzistenca e një aktgjykimi dënues dhe është i zbatueshëm për një numër të veprave penale të përcaktuara me ligjin në fjalë.

Procedura e konfiskimit civil në Slloveni fillon me hetimin financiar i cili zhvillohet nga prokuroria. Në këtë fazë, barra për të provuar se pasuria e targetuar është me origjinë joligjore është mbi prokurorinë. Nëse kjo e fundit gjatë këtij hetimi financiar gjenë mospërputhje në mes të të ardhurave të deklaruara dhe pasurisë së përgjithshme, atëherë prezumohet se pasuria në fjalë është fituar përmes veprimtarisë së kundërligjshme. Në këtë rast, barra e provës bartet tek personi i dyshuar i cili ka mundësinë të rrëzojë prezumimin e origjinës së kundërligjshme të pasurisë së tij duke dëshmuar se pasuria në fjalë është fituar në mënyrë të ligjshme. Nëse dështon për të bërë një gjë të tillë, atëherë gjykata kompetente jep urdhër për konfiskimin e pasurisë.

Ngjashëm, ndonëse me fushëveprim më të kufizuar, është edhe **Gjermania**. Gjermania në rastet e krimit të organizuar dhe terrorizmit lejon konfiskimin e pasurisë edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues nëse personi i dyshuar dështon të provojë se pasuria e tij ka origjinë të ligjshme. Pra, në rastet e korrupsionit dhe terrorizmit, barra e provës transferohet tek personat e dyshuar.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, njëra prej modeleve më të njohura të konfiskimit civil në Evropë, është modeli i **Italisë**. Konfiskimi civil në Itali ka tre karakteristika themelore. Së pari, ky model parasheh konfiskimin e pasurisë e cila dyshohet se është fituar përmes veprimtarisë së kundërligjshme e cila paraqet rrezik për shoqërinë. Së dyti, prokurori nuk është i detyruar që të dëshmojë se pasuria e targetuar është me të vërtetë derivat i veprimtarisë së caktuar joligjore. Është e mjaftueshme për prokurorin të dëshmojë vetëm ekzistencën e mospërputhshmërisë në mes të pasurisë në fjalë dhe të ardhurave të deklaruara të personit të dyshuar. Pasi që prokurori ta ketë arritur të dëshmojë një mospërputhshmëri të tillë, krijohet prezumimi se pasuria e targetuar ka origjinë të paligjshme dhe rrjedhimisht barra e provës bartet tek personi i dyshuar. Nëse ky i fundit dështon të arsyetojë origjinën e ligjshme të pasurisë së tij, atëherë të njëjtit i konfiskohet pasuria ndonëse nuk është vërtetuar kryerja e ndonjë vepre penale e as nuk është bërë lidhja e pasurisë me veprën e tillë.

Nuk do mend se secili prej modeleve konfiskuese të trajtuara më lartë dallon prej tjetrit për shkak të kornizës së veçantë ligjore dhe institucionale që secili shtet ka. Veç kësaj, edhe më i pamohueshëm është fakti se vetëm pse një model konfiskimi ka rezultuar i suksesshëm në shtetet si më lartë, nuk garanton zbatimin e suksesshëm të tij në Kosovë. Mirëpo, janë disa elemente të konfiskimit civil *in rem* të cilat, meqë janë treguar frytdhënëse në shtetet e përmendura më lartë, kanë potencial të japin fryte pozitive edhe në Kosovë.

Megjithatë, krahas fryteve pozitive që mund t'i prodhojë ky model, është e rrugës të theksohen edhe hezitimet që grupi punues ka për këtë të fundit. Sipas Koordinatorit

Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, fakti që ky model kërkon që të vërtetohet se pasuria është fituar përmes aktiviteteve joligjore, mund të tregohet mjaft problematike për vendin tonë. Sipas të njëjtit, nocioni i aktiviteteve joligjore dhe kriminale shpesh herë shkakton huti në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për shembull, tek vepra penale e shpërlarjes së parave, ka prokurorë dhe gjyqtarë të cilët mendojnë se kjo vepër penale duhet të ndiqet vetëm nëse pasohet me një vepër tjetër penale bazë apo vepër të ndërlidhur penale. Krahas tyre, është kategoria tjetër e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk e shohin të nevojshme ekzistimin e një vepre të ndërlidhur penale për të filluar ndjekjen penale. Ndaj, në praktikë, do të ishte jashtëzakonisht e vështirë që të zbatohet një ligj i cili kërkon vërtetimin e aktiviteteve kriminale kur gjyqtarët dhe prokurorët kanë vështirësi në kuptimin e plotë të nocionit në fjalë.

Në cilindo rast, sikurse Kosova të vendosë që të adoptojë këtë model, atëherë, ligji i ri për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme i cili do të projektonte praktikat më të mira të shteteve të elaboruara më lartë, do të aplikohej për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ligji i ri do të përmirësonte funksionimin e përgjithshëm të institutit ligjor të konfiskimit të pasurisë së pajustifikueshme, duke përcaktuar mes tjerash:

- Kushtet për vërtetimin e pasurisë duke u bazuar indikatorët si në vijim:
    i. i dyshuari ka sajuar pasurinë në bazë të ndonjë veprimtarie e cila paraqet rrethanë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
    ii. i dyshuari ka transferuar tërë pasurinë e tij apo një pjesë të saj tek personat e tretë pa kompensim apo me kompensim i cili nuk është ekuivalent me vlerën e pasurisë së transferuar;
    iii. të hyrat legjitime të të dyshuarit kanë qenë të pamjaftueshme për të mundësuar blerjen e pasurisë;
    iv. nga veprimtaria të cilën e ushtron i dyshuari rezulton mundësia e kryerjes së veprës penale që ndërlidhet me motivin e përfitimit material.

- Pasuria e cila mund të jetë objekt i vërtetimit, krahas asaj mbi të cilën i dyshuari ka titullin e pronësisë, përfshinë edhe pasurinë në përdorim. I dyshuari prezumohet të jetë pronar i pasurisë në përdorim nëse ai rregullisht paguan mirëmbajtjen e saj, rinovimin, apo faturat e shërbimeve të tjera, edhe në rastet kur kjo pasuri fshihet përmes korporatave dhe personave të tjerë;

- Pesë fazat e procesit të konfiskimit ashtu siç janë të përcaktuara në Dokumentin e Punës të Komisionit Evropian të vitit 2012[12]:

[12] Shih https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52012SC0031&from=en.

i. Identifikimi - përmes hetimeve financiare që ndihmojnë në përcaktimin e pasurive që potencialisht kanë origjinë të paligjshme;
ii. Ruajtja - ngrirja apo sekuestrimi i pasurisë (kërkesë, mjete juridike dhe urdhri gjyqësor);
iii. Konfiskimi - konfiskimi përfundimtar përmes një vendim gjyqësor;
iv. Përmbarimi - zbatimi i urdhrit (proceduar për kalimin e pasurisë ligjërisht tek autoritetet);
v. Rishpërndarja - kush dhe si administrojnë pasurinë; rastet kur mbahet pasuria e kur duhet shitur.

- Autoritetet kompetente lidhur me konfiskimin civil. Ndonëse sipas praktikave të shumë vendeve të tjera, konfiskimi civil inicohet nga prokuroria, një opsion i tillë është më vështirë i realizueshëm në Kosovë. Kjo për faktin se kuadri ligjor i Kosovës duket të jetë më i kufizuar në këtë drejtim. Neni 109 (1) të Kushtetutës së Kosovës, përcakton se "*Prokurori i Shtetit është një institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të* ***personave*** *të akuzuar për kryerjen e* ***veprave penale*** ***<u>dhe veprimeve të tjera</u>*** *<u>të përcaktuara me ligj</u>*." Janë dy elemente të cilat dalin nga ky nen, parimi *in personam* dhe kërkesa për ndjekjen e personave të *akuzuar për kryerjen e veprave penale.* Sikurse konfiskimi civil të inicohet nga Prokurori i Shtetit, atëherë i njëjti do të duhej të iniconte procedurë kundër sendit (*in rem)* të personave të cilët nuk janë të akuzuar për kryerjen e veprës penale. Kjo do të binte në kundërshim me prerogativat kushtetuese të Nenit 109. Ndonëse Neni 109 tutje përcakton që kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj, sërish shqetësimet qëndrojnë marrë parasysh faktin se esenca e punës së Prokurorit të Shtetit është ndjekja penale dhe sikurse kompetenca për realizimin e konfiskimit civil të bie mbi Prokurorin e Shtetit atëherë do të mund të krijohej huti në mes të konfiskimit civil dhe atij tradicional penal. Ndaj, me qëllim të evitimit të shkeljes potenciale të Kushtetutës dhe të krijimit të kësaj hutie, kompetenca për inicimin e konfiskimit civil është më preferuar t'i jepet një agjencie tjetër jo-prokuroriale.

- Sa i përket caktimit të autoritetit kompetent për konfiskim civil, planifikohet krijimi dhe fuqizimi i mekanizmit të ri me ketë kompetencë (Agjenci ose tjetër), e cila do t'i ketë afërsisht 30 të punësuar. Sikurse të procedohet me këtë opsion, duhet të bëhet amandamentimi i kornizës ligjore që rregullon veprimtarinë, për të shtuar konfiskimin civil në kuadër të kompetencave dhe potencialisht për të paraparë një njësi të veçantë përbrenda mekanizmit i cili do merrej me çështjen e konfiskimit civil. Gjithashtu, opsion tjetër është krijimi i një agjencie të re të pavarur (rasti i Bullgarisë)

me kompetencë ekskluzive lidhur me konfiskimin civil, përkitazi me Nenin 142 të Kushtetutës;

- Në rastet kur autoritetet e autorizuara për konfiskim civil, në bazë të indikatorëve të përcaktuar me ligj, vlerësojnë se dobia pasurore është fituar përmes veprimtarisë joligjore, të njëjtat do t'i përcjellin të gjitha informatat tek Prokurori i Shtetit. Prokurori i Shtetit në pajtim me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, do të ndërmarrë veprimet procedurale për realizimin e konfiskimit penal. Nëse ky i fundit, nuk është i suksesshëm në konfiskimin e pasurive ose konsiderohet se vepra e pretenduar nuk është e natyrës penale, atëherë agjencitë e autorizuara mund të veprojnë për të filluar procedurat për konfiskimin civil të pasurisë. Kjo siguron që konfiskimi civil të përdoret si mjet i fundit dhe eviton mundësinë e përdorimit të tij në mënyrë arbitrare;

- Agjencia e autorizuar paraqet kërkesën për konfiskim civil pranë gjykatës brenda territorit të së cilës gjendet pasuria që përbën objekt të shqyrtimit gjyqësor. Në rast së pasuria është e shpërndarë në disa vende të ndryshme[13] të cilat përbëjnë kompetencën e gjykatës apo gjykatave të tjera themelore, kompetente për vërtetimin dhe shqyrtimin e pasurisë do të jetë gjykata në territorin e së cilës gjendet vendbanimi i poseduesit të pasurisë. Sipas gjasave (standardi i bilancit të probabiliteteve), agjencia duhet të provojë se pasuria e të dyshuarit ka origjinë joligjore. Nëse agjencia është e suksesshme në këtë drejtim, sipas kërkesës së të njëjtës, gjykata do të urdhërojë sekuestrimin e pasurisë së kontestuar. Me këtë rast, barra e provës do të bartet tek i dyshuari i cili duhet të dëshmojë se pasuria e tij ka origjinë legjitime. Nëse i dyshuari dështon të bëjë një gjë të tillë, atëherë, pasuria e cila është objekt i shqyrtimit konfiskohet përfundimisht dhe e njëjta bartet në pronë të shtetit. Në të kundërtën, pasuria e sekuestruar do të lirohet.

- Administrimi i pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar bëhet nga ana e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Dispozitat e Ligjit 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar vlejnë *mutatis mutandis* edhe për pasurinë e konfiskuar në mungesë të aktgjykimit dënues.

- Procedura e konfiskimit civil duhet të zhvillohet brenda një periudhe të arsyeshme. Në këtë drejtim mund të synohet harmonizimi me Ligjin Nr. 06/L-087 për

[13] Ky paragraf nuk ka për qëllim të rregullojë kompetencën e gjykatës së huaj. Kur përmenden vendet e ndryshme në të cilat mund të jetë e shpërndarë pasuria e të dyshuarit, mendohet për vende të ndryshme brenda territorit të Kosovës.

Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë i cili parasheh që brenda 30 ditëve pas dorëzimit të kërkesës për verifikim të pasurisë, Gjykata të mbanë seancë dëgjimore dhe e njëjta nxjerrë vendimin e arsyetuar për pasurinë e paraqitur në kërkesën për verifikim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së seancës dëgjimore.

- Procedurat operative të parapara me Ligjin Nr.06-/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë në lidhje me urdhërat e kufizimit, urdhërat e zbulimit dhe procedurat e verifikimit mund të aplikohen *mutatis mutandis* edhe për konfiskimin civil.

- Rastet e konfiskimit civil do të shqyrtohen nga trupi gjykues në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda pranë Gjykatës Themelore të kompetencës territoriale. Kjo për shkak të përvojës dhe ekspertizës që ky departament ka në fushën e konfiskimit të pasurisë. Megjithatë, duke pasur parasysh hutinë që kompetenca e këtij departamenti mund të shkaktojë në mes të procedurës civile të konfiskimit dhe asaj penale, është jashtëzakonisht e rëndëisishme që ligji i ri të precizojë në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë që Departamenti për Krime të Rënda në kuadër të Gjykatës Themelore do të ketë në lidhje me konfiskimin civil dhe të theksojë se kompetenca e këtij departamenti nuk i jep natyrë penale konfiskimit civil.

- Vlerën minimale monetare e cila shërben si prag për inicimin e hetimit për konfiskim civil, duke marrë parasysh edhe praktikat e vendeve të tjera siç janë përcaktuar në këtë Koncept Dokument. Në lidhje me këtë, mund të synohet edhe harmonizimi  me Ligjin nr. 05/l -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit i cili përfshinë nën fushëveprimin e tij për raportim, verifikim dhe masa parandaluese transaksionet në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë.

- Kompetenca e mekanizmit të autorizuar për të hetuar dhe proceduar lidhur me konfiskimin civil shtrihet në të gjithë territorin e Republikë së Kosovës.

- Trajnimet që duhet ndjekur nga gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e agjencisë së autorizuar për konfiskim civil, dhe akterë të tjerë zbatues të ligjit sa i përket njohjes dhe përvetësimit të parimeve dhe procedurës së konfiskimt civil dhe diferencave të të njëjtës me konfiskimin penal.

- Aplikimin retroaktiv të ligjit prej vitit 1999 (si pikë referuese e ndryshimit të situatës politike të Kosovës) e tjetje.

- Kundër vendimit të Gjykatës Themelore për konfiskim mund të paraqitet ankesë pranë Departamenit për Krime të Rënda të Gjykatës së Apelit.

- Mundësimin e kompensimit ndaj personave pasuria e të cilëve gabimisht është sekuestruar apo konfiskuar. Në parim, nëse i dyshuari arrinë të dëshmojë origjinën e ligjshme të pasurisë së kontestuar, çoftë në shkallë të parë apo të dytë, atëherë pasuria e sekuestruar apo e konfiskuar do t'i kthehet. Në rast se pasuritë nuk janë më në dispozicion për t'u kthyer, i dyshuari ka të drejtë për kompensim për dëmet e shkaktuara nga konfiskimi apo sekuestrimi i pajustifikuar në përputhje dhe mutatis mutandis me dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale.

- Koordinim më të mirë dhe më të intesifikuar në mes të organeve relevante.

Si përmbledhje, mund të thuhet se miratimi i një ligji të tillë, do t'i adresonte një sërë problemesh të identifikuara në Kapitullin 1 të këtij Koncept Dokumenti. Së pari, miratimi i një ligji të ri i cili ofron bazë të re ligjore mbi të cilën mund të realizohet konfiskimi, do të ndikonte drejtpërsëdrejti në rritjen e numrit të përgjithshëm të konfiskimeve. Kjo për faktin se krahas konfiskimit me bazë penale, institutetet përkatëse do të mund paraqitnin kërkesë për konfiskim edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues. Veç kësaj, prezantimi i standardit të bilancit të probabiliteteve në procedurën e konfiskimit civil i cili parashihet përmes këtij ligji, do të ndikonte edhe më tej në rritjen e numrit të konfiskimeve dhe në përgjithësi të efikasitetit të sistemit të konfiskimit në vend duke mundësuar kësisoji që kërkesat për konfiskim civil të arsyetohen me më pak vështirësi. Tutje, për shkak se ligji i ri do të merrej vetëm me konfiskimin civil, duke lënë jashtë kornizave të tij institutin e konfiskimit penal i cili veçse është i rregulluar me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe kuazi-penal, siç përcaktohet në Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, nuk do të krijohej huti lidhur me atë se logjika e cilit akt ligjor duhet të përdoret kur vie tek rastet e konfiskimit. Me fjalë të tjerë, sferat e veprimit të këtyre akteve ligjore, do të dalloheshin mirë e qartë. Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri mbi konfiskimin civil do të kontribonte edhe në një koordinim më të mirë të akterëve me interes në procesin e konfiskimit duke përcaktuar qartazi kompetencat dhe detyrat e secilit veç e veç. Ligji i ri, duke përcaktuar specializimin e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve të tyre profesionalë, zyrtarëve të mekanizmit me kompetencë për realizimin e konfiskimit civil, dhe palëve të tjera të intersit, ka potencial të ndikojë pozitivisht në efikasitetin e sistemit të konfiskimit në vend. Jo vetëm duke adresuar zvarritjen e procedurave të konfiskimit, mirëpo edhe duke adresuar mungesën e arsyetimit të plotë të kërkesave dhe vendimeve për konfiskim të pasurisë joligjore.

Thënë në tërësi, ligji i ri për konfiskim në mungesë të aktgjykimit dënues do të prodhonte dy efekte madhore rritjen e efikasitetit të sistemit të konfiskimit në vend e cila do të rezultonte me rritjen e numrit të përgjithshëm të konfiskimeve dhe demotivimin e kriminalitetit.

Krahas këtij modeli, siç u përmend edhe më lartë, ekziston edhe **modeli i dytë i konfiskimit civil** i cili bënë krahasimin e pasurisë së përgjithshme të personave të caktuar me të ardhurat e deklaruara, me qëllim të identifikimit të diskrepancës mes tyre.

Model i mirë studimi në këtë drejtim është ai i **Bullgarisë**. Bullgaria në vitin 2018 miratoi Ligjin për luftimin e korrupsionit dhe konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Përmes këtij ligji, Bullgaria themeloi Komisionin për Luftimin e Korrupsionit dhe Pasurive të Paligjshme si një organ shtetëror i pavarur, i specializuar, dhe me veprim të përhershëm. Sipas këtij ligji, konfiskimi civil ka për qëllim që të bëjë verifikimin e pasurisë së personave të caktuar për të vërtetuar nëse kjo e fundit korrespondon me të ardhurat e deklaruara. Aktgjykimi dënues nuk është parakusht për konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme.

Ligji në fjalë është i aplikueshëm vetëm për ata persona të cilët mbajnë funksione të larta publike e të cilët janë të caktuar në mënyrë taksative në nenin 6 të këtij ligji. Këta persona, sipas këtij ligji, janë të detyruar që të deklarojnë pasurinë e tyre. Pasi që pasuria të jetë deklaruar, Komisioni për Luftimin e Korrupsionit dhe Pasurive të Paligjshme, si masë për luftimin e korrupsionit, krahason pasurinë e deklaruar të këtyre personave me pasurinë e përgjithshme. Nëse Komisioni gjen diskrepancë në mes të pasurisë së përgjithshme dhe të ardhurave të deklaruara në vlerë prej rreth 10.000 Euro, atëherë krijohet prezumimi se pasurisa në fjalë është me origjinë të kundërligjshme dhe rrjedhimisht bëhet konfiskimi i saj. Kjo nëse personat të cilët mbajnë funksione të larta publike dështojnë të provojnë origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre.

Konfiskimi civil rregullohet në mënyrë të ngjashme edhe në **Rumani**. Konfiskimi civil në Rumani është i rregulluar përmes Ligjit Nr. 144/2007 për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit. Ngjashëm me Bullgarinë, ky ligj aplikohet vetëm për zyrtarët publikë në raste të tilla kur ka një diferencë të pajustifikueshme në vlerë prej 10.000 Euro në mes të të ardhurave të deklaruara dhe pasurisë së përgjithshme të tyre.

Sikurse Kosova të vendosë që të adoptojë modelin e dytë të konfiskimit civil, atëherë janë disa çështje themelore të cilat duhet të adresohen me ligjin e ri.

Së pari, ligji duhet të përcaktojë se mbi çfarë baze mund të realizohet konfiskimi civil sipas këtij modeli. Ky opsion sugjeron që konfiskimi civil të realizohet mbi bazën e identifikimit të diskrepancës në mes të pasurisë së përgjithshme të personave të dyshuar dhe të ardhurave të tyre. Ky proces do të përfshijë si pasurinë që nuk është deklaruar fare, ashtu edhe pasurinë që është deklaruar por nuk korrospondon me të ardhurat legjitime. Kjo diskrepancë duhet të ketë vlerë jo më të vogël se 5.000 Euro në mënyrë që të përdoret si indikatorë për inicimin e procedurës së konfiskimit civil.

Tutje, ligji duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë kategorinë e personave mbi të cilët do të aplikohet. Ky opsion sugjeron që fushëveprimtaria e ligjit të shtrihet mbi:

i. Zyrtarët e lartë publik dhe anëtarët e tyre të familjes; dhe
ii. Personat e ekspozuar politikisht, anëtarët e tyre të familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë.

Si orientim lidhur me atë se kush mund të hyjë në kuadër të kategorisë së parë, mund të merret Ligji nr. 04/l-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-228 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Kështu, përkufizimi "zyrtarë i lartë publik" sipas Ligji nr. 04/l-050 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-228[14], përfshinë personat si më poshtë:

- Presidenti i Republikës së Kosovës, anëtarët e kabinetit të Presidentit, Sekretarin si dhe Drejtorët e Departamenteve Profesionale në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të emëruarit nga ai;
- Deputetët e Kuvendit, të gjithë personat e zgjedhur apo të emëruar nga Kuvendi, Kryesia, Kryetari i Kuvendit si dhe Kabineti i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, Zëvendës Ministrat, Këshilltarët politik, Shefat e kabineteve si dhe të gjithë te emëruarit nga ta;
- Sekretarët e Përgjithshëm të Qeverisë, kryeshefat e Agjencive sapo pozitat e barasvlershme të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër dhe të emëruarit e tyre,

[14] Pas miratimit të Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë i cili është në punim e sipër nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, lista e zyrtarëve të lartë publikë në të cilët bënë referencë ky Koncept Dokument, do të përditësohet.

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, Drejtorët regjional të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve të Doganës;
- Auditorët në Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe të gjithë auditorët e brendshëm te institucioneve;
- Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, kryeshefat, Zëvendës-Kryeshefat, sekretarët e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe lokal, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër;
- Anëtarët e Bordit, Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Bankës Qendrore;
- Kryetarët e Komunave dhe Zëvendës Kryetarët, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale;
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor;
- Gjyqtarët dhe Prokurorët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Gjykatës Kushtetuese;
- Udhëheqësit e të gjitha Departamenteve, Drejtorive, Drejtorateve apo njësive të barasvlershme, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit Publik në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike;
- Ambasadorët, Konsujt, Zëvendës Konsujt, Sekretarët e Ambasadave apo Konsullatave të Republikës se Kosovës;
- Rektori dhe Prorektorët e Universitetit Publik, anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik, Dekanët dhe Prodekanët, si dhe Sekretari i Universitetit Publik dhe Njësive Akademike;
- Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtoret dhe Drejtoret rajonal të Policisë së Kosovës, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Komandanti, Zëvendës Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Drejtori, Zëvendës Drejtori si dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës;
- Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij;
- Kryeinspektorët dhe zëvendës kryeinspektorët e Inspektorive të nivelit qëndror dhe lokal;
- Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Të gjithë ushtruesit e detyrës në pozitat e lartpërmendura që ushtrojnë detyrën më gjatë se tre (3) muaj.

Paralelisht, sipas të njëjtit ligj, anëtarë të familjes së zyrtarëve të lartë publik konsiderohen bashkëshortët, bashkëshortët jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët me të cilët jeton në

bashkësi familje. E njëjta logjikë mund të ndiqet edhe te ligji që propozohet të miratohet me nën-opsionin 3.2 duke siguruar kësisoji harmoni mes ligjeve gjegjëse.

Krahas kategorisë së parë, përmes këtij opsioni sugjerohet që ligji i ri të zbatohet edhe për personat e ekspozuar politikisht, anëtarët e tyre të familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë ashtu siç përcaktohet me Dyzet Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar[15] dhe me Udhëzimin Administrativ MF (NJIF-K) Nr. 02-2018 për Personat e Ekspozuar Politikisht.[16]

Persona të ekspozuar politikisht, sipas Nenit 3 të Udhëzimit Administrativ MF (NJIF-K) Nr. 02-2018 për Personat e Ekspozuar Politikisht i cili është në harmoni me Dyzet Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar, janë personat fizik vendor ose të huaj të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të rëndësishme publike, përveç zyrtarëve të nivelit të mesëm ose të ulët.

Në anën tjetër, anëtarët e familjes konsiderohen bashkëshortët ose çdo person i cili konsiderohet ekuivalent i bashkëshortit, fëmijët dhe bashkëshortët e fëmijëve ose personat e konsideruar si ekuivalentë të bashkëshortëve dhe prindërit. Së fundi, në kategorinë e bashkëpunëtorëve të ngushtë të personave të ekspozuar politikisht hynë çdo person fizik i cili njihet si pronar i përbashkët përfitues i një personi juridik apo marrëveshje juridike ose në çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi me një person të ekspozuar politikisht; çdo person fizik i cili është pronar i vetëm përfitues i një personi juridik apo marrëveshje juridike që njihet që është themeluar për përfitime de facto të një personi të ekspozuar politikisht.

Së fundi, ligji duhet të përcaktojë autoritetin kompetent për konfiskim civil dhe procedurën e cila duhet të ndiqet me këtë rast. Ajo çfarë është thënë për autoritetin kompetent për realizimin e konfiskimit civil në opsionin 3.1 mund të aplikohet përshtatshmërisht edhe këtu.

Alternativisht, duke i marrë parasysh specifikat e këtij modeli, ky opsion sugjeron që Agjencia kundër Korrupsionit të monitorojë mënyrën e jetesës së zyrtarëve të lartë publikë dhe personave të ekspozuar politikisht me qëllim të përcaktimit të përputhshmërisë, gjegjësisht mungesës së saj, në mes të të ardhurave të deklaruara dhe pasurisë së tyre të përgjithshme. Agjencia bënë monitorimin e stilit të jetesës në bazë të informatave të marra

---

[15] Shih https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/Guidance-PEP-Rec12-22.pdf.
[16] Shih http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/09/UA_p%C3%ABr_Personat_e_Ekspozuar_Politikisht_dt_03-09-2018.pdf.

nga personat fizik dhe juridik, nga media dhe burimet e tjera të hapura të informacionit. Procedura për monitorimin e stilit të jetesës përcaktohet nga Agjencia dhe ky monitorim duhet të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëse Agjencia arrinë të identifikojë diskrepancë në mes të pasurisë dhe të ardhurave të deklaruara të zyrtarëve të lartë publikë apo personave të ekspozuar politikisht, atëherë do të krijohet prezumimi që pasuria e pajustifikueshme është fituar në mënyrë të kundërligjshme. Me këtë rast, Agjencia do t'i përcjellë në prokurori të gjitha informacionet për veprën e pretenduar në rast se beson se përmban elemente të veprës penale. Nëse prokuroria nuk është e suksesshme në konfiskimin e pasurive ose konsiderohet se vepra e pretenduar nuk është natyrës penale, atëherë Agjencia mund të veprojë për të filluar procedurat për konfiskimin e pasurisë.

Ngjashëm me opsionin 3.1, Agjencia paraqet kërkesën për konfiskim civil pranë gjykatës brenda territorit të së cilës gjendet pasuria që përbën objekt të shqyrtimit gjyqësor. Në rast së pasuria është e shpërndarë në disa vende të ndryshme të cilat përbëjnë kompetencën e gjykatës apo gjykatave të tjera themelore, kompetente për vërtetimin dhe shqyrtimin e pasurisë do të jetë gjykata në territorin e së cilës gjendet vendbanimi i poseduesit të pasurisë. Pasi që Agjencia të ketë arritur të identifikojë diskrepancën në mes të pasurisë dhe të ardhurave të deklaruara të zyrtarëve të lartë publikë apo të personave të ekspozuar politikisht, atëherë do të krijohet prezumimi se pasuria në fjalë ka origjinë të kundërligjshme dhe me këtë rast gjykata, sipas kërkesës së Agjencisë, do të urdhërojë sekuestrimin e saj. Me këtë rast, barra e provës do të bartet tek i dyshuari i cili duhet të dëshmojë se pasuria e tij ka origjinë legjitime. Nëse i dyshuari dështon të bëjë një gjë të tillë, atëherë, pasuria e cila është objekt i shqyrtimit konfiskohet përfundimisht dhe e njëjta bartet në pronë të shtetit. Procedura e konfiskimit civil duhet të zhvillohet brenda një periudhe të arsyeshme.

Krahas këtyre, ajo çfarë është thënë më lartë në kuadër të opsionit 3.1 në lidhje me kompetencën e Departamentit për Krime të Rënda në kuadër të gjykatës përkatëse, kompetencën territoriale të agjencicë së autorizuar për konfiskim civil, ofrimin e trajnimeve për konfiskim civil, ankimimin kundër vendimit të gjykatës në lidhje me konfiskimin civil, kompensimin në rast të sekuestrimit apo konfiskimit të gabuar, koordinimin e organave relevante dhe fushëveprimin kohor të ligjit, vlen përshtatshmërisht edhe për këtë opsion.

Edhe këtu duhet të nënvizohet se miratimi i ligjit për konfiskimin civil të pasurisë së pajustifikueshme të zyrtarëve të lartë publik nuk duhet të rezultoj me shfuqizimin e LKZKP-së. Në të kundërtën, një veprimi i tillë do rëndonte shumë pozitën dhe trajtimin e zyrtarëve të lartë publik në krahasim me kategoritë e tjera shoqërore. Në një skenar të tillë, do mundësohej që zyrtarëve të lartë publik t'u konfiskohej çfarëdo pasurie e fituar në

mënyrë të pajustifikueshme, madje edhe pa aktgjykim dënues, ndërkaq të tjerëve në mungesë të LKZKP-së do mund tu konfiskohej pasuria e fituar vetëm përmes veprës konkrete penale për të cilën janë shpallur fajtor, situatë kjo e cila do të mund të rezultone në trajtim të pabarabartë në mes të qytetarëve.

**Krejt në fund, është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet që për shkak të vështirësive në provimin e pronës nga ana e të dyshuarit në vendin tonë dhe mungesën e përvojës së organeve zbatuese të ligjit lidhur me konfiskimin civil, është e rëndësisë esenciale që dizajnimi i konfiskimit civil të bëhet me kujdesin më të madh të mundur në mënyrë që të evitohet mundësia e përdorimit arbitrar të këtij mekanizmi.**

# Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen

Në tabelën në vijim janë renditur ndikimet më të rëndësishme të identifikuara të dy opsioneve të para. Ndikimet e opsionit të tretë në anën tjetër, do të trajtohen ndaras duke marrë parasysh preferencën e grupit punues për këtë opsion.

Anekset 1 deri në 4 tregojnë vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, sociale, mjedisore si dhe ndikimet në të drejtat themelore. Këto mjete janë renditur në Doracakun për Zhvillimin e Dokumenteve Koncept. Katër anekset tregojnë gjithashtu vlerësimet e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe shkallën e preferuar të analizës.

*Figura 4: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara sipas kategorisë së ndikimit për dy opsionet e para*

| Kategoria e ndikimeve të mundshme | Opsioni 1 | Opsioni 2 |
|---|---|---|
| **Ndikimet ekonomike** | N/A | N/A |
| **Ndikimet sociale** | *Krimi dhe siguria*<br><br>Konfiskimi i pasurisë së pajustifikueshme është qenësore për objektivën e përgjithshme të luftimit të krimit në secilin vend të botës e Kosova nuk bënë përjashtim. | *Krimi dhe siguria*<br><br>Masat ligjore të propozuara me opsionin e dytë mund të kenë ndikime pozitive sociale meqë të gjitha prej tyre synojnë një zbatim më efikas të sistemit të konfiskimit në vend dhe rrjedhimisht një luftim më të |

| | | |
|---|---|---|
| | Vazhdimi i gjendjes aktuale nuk pasqyron nevojën për përmirësimin dhe avancimin e kësaj fushe. Siç është përcaktuar në përkufizimin e problemit, në praktikë, janë identifikuar shumë probleme të cilat e bëjnë kornizën aktuale ligjore në fushën e konfiskimit të pasurisë jo efikase dhe jo funksionale.<br><br>Shqetësuese nuk është vetëm fakti që numri i përgjithshëm i konfiskimeve përfundimtare bazuar në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është tejet i vogël, mirëpo posaçërisht mungesa e rastve të të konfiskimit të bazuara në Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.<br><br>Marrë parasysh këtë situatë, mund të konkludohet se në aspektin social, skema aktuale legjislative nuk ka ndonjë ndikim pozitiv.<br><br>Përkundrazi, vazhdimi i kësaj situate nënkupton vazhdimin e luftimin jo të suksesshëm të kriminalitetit në vend, e kjo në fakt përkthehet si ndikim negativ social. | mirë të krimit dhe siguri më të madhe në vend. |
| **Ndikimet mjedisore** | / | / |
| **Ndikimet në të drejtat themelore** | / | / |

| | | |
|---|---|---|
| **Ndikimi gjinor** | Infrastruktura ligjore aktuale nuk ka ndonjë ndikim gjinor të drejtpërdrejtë, meqenëse ligjet e aplikueshme adresojnë çështje jo specifike për nga gjinia. | Masat e propozuara nën Opsionin 2 nuk kanë ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë gjinor, duke pasur parasysh se ligjet e zbatueshme nuk trajtojnë çështje specifike. |
| **Ndikimet në barazinë sociale** | Nuk ka ndikime. | Nuk ka ndikime |
| **Ndikimet në rini** | Nuk ka ndikime. | Nuk ka Ndikime |
| **Ndikimet në ngarkesën administrative** | / | / |
| **Ndikimi në NVM** | / | / |
| **Ndikimi buxhetor** | Ky opsion nuk ka kosto shtesë që do ta ngarkonte buxhetin e Kosovës.<br><br>Vlerësimi i ndikimit buxhetor është paraqitur në dokumentin e bashkangjitur. | Ky opsion ka një kosto shtesë nominale që e ngarkon buxhetin e Kosovës marrë parasysh fondet të cilat duhet të investohen në ngritjen e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale.<br><br>Vlerësimi i ndikimit buxhetor është paraqitur në dokumentin e bashkangjitur. |

## 4.1 Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve për opsionin e tretë

Për shkak se opsioni i tretë duket të jetë opsioni më i preferuar ndër anëtaret e grupit punues, ndikimet e këtij opsioni meritojnë trajtim më të detajuar dhe ndaras nga dy opsionet e tjera.

| **Kategoria e ndikimeve të mundshme** | **Opsioni 3** |
|---|---|

| | |
|---|---|
| **Ndikimet ekonomike** | *Rritja ekonomike*<br><br>Masat e propozuara me miratimin e një ligji të ri i cili do të mundësonte realizimin e konfiskimit në procedurë civile dhe në mungesë të aktgjykimit dënues pritet të kenë ndikime pozitive ekonomike. Kjo për faktin se të gjitha të mirat materiale e konfiskuara duke u mbështetur në këtë kornizë të re legjislative, do të derdheshin në buxhet të shtetit , të cilat mjete pastaj do të mund të shfrytëzohen qoftë për kompensimin e viktimave, infrastrukturë sociale apo për financimin e politikave të tjera shtetërore. |
| **Ndikimet sociale** | *Krimi dhe siguria*<br><br>Masat e propozuara me këtë opsion do të kenë ndikime të shumëfishta pozitive sociale.<br><br>Së pari, masat ligjore të propozuara me këtë opsion synojnë të parandalojnë përsëritjen e sjelljeve kriminale përmes largimit të burimit të tyre financiar, gjegjësisht përmes konfiskimit të pasurisë së pajustifikueshme.<br><br>Tutje, konfisikimi i pasurisë së pajustifikueshme adreson shqetësimet se pasuria e madhe kriminale, e gjeneruar më së shumti nga format e ndryshme të veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar, rrezikon të destabilizojë sistemin financiar dhe të korruptojë shoqërinë legjitime.<br><br>Së fundi, dhe më së rëndësishmi, konfiskimi si çelësi i luftimit të suksesshëm të krimit të organizuar dhe korrupsionit në secilin vend, përkrah sundimin e ligjit dhe parimin moral që askush nuk duhet të përfitojë nga krimi. |
| **Ndikimet mjedisore** | N/A |
| **Ndikimet në të drejtat themelore** | *Të drejtat pronësore dhe Administrimi i mirë*<br><br>Masat e propozuara me opsionin 3 potencialisht mund të kenë ndikime negative në të drejtën në pronë të qytetarëve të Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe aktet e tjera ligjore |

relevante të kësaj fushe, përcaktojnë se e drejta në pronë është e drejtë e garantuar dhe se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona e vet. Ngjashëm, edhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, e aplikueshme në Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës, përcakton të drejtën në pronë si të drejtë absolute.

Mund të argumentohet se konfiskimi i pasurisë në mungesë të një aktgjykimi dënues mund të përbëjë shkelje të kësaj të drejte absolute. Megjithatë, këtu vlen të theksohet se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk ka arritur në një përfundim të tillë.

Një prej rasteve të para ku Gjykata Evropian për të Drejtat e Njeriut ka shqyrtuar përputhshmërinë e institutit të konfiskimit civil me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut është *Engel kundër Holandës*[17]. Në këtë rast, Gjykata shqyrtoi kundërshtimet për praktikat e konsfiskimit në procedurë civile dhe në mungesë të aktgjykimit dënues dhe konsensusi gjithëpërfshirës ishte që konfiskimi civil është i pajtueshëm me mbrojtjen e të drejtës së pronës (si e drejtë e mbrojtur nga instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut si dhe legjislacioni vendor), mbi bazën që kjo e drejtë është e drejtë e kufizuar e jo absolute, dhe është e mundur të jetë subjekt i ndërhyrjes, me kusht që ndërhyrja e tillë të jetë:

- e parashikuar me ligj, bazuar në parimin e ligjshmërisë;
- të ndjekë një qëllim të ligjshëm; dhe
- të jetë proporcionale.

Ngjashëm, edhe në rastin *Arcuri kundër Italisë*[18], ku Arcuri dyshohej se ishte anëtar i një organizate kriminale të angazhuar në trafik droge. Prokurori kërkoi masa parandaluese dhe kërkoi konfiskimin e pasurive të tij në bazë të mospërputhjes midis pasurive të tij dhe të ardhurave financiare, kur u krahasua me biznesin / të ardhurat e tij legjitime. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk gjeti

[17] Shih https://hudoc.echr.coe.int/tur#{"itemid":["001-57479"]}.
[18] Shih https://www.juridice.ro/wp-content/uploads/2015/08/ARCURI-OTHERS-v-ITALY-ECHR-Decision-_English_.pdf.

| | |
|---|---|
| | shkelje të së drejtës në pronë. Ngjashëm, shkelje e së drejtës në pronë nuk u gjet as në rastin *Raimondo kundër Italisë* ku ishte urdhëruar konfiskimi i pasurisë e cila dyshohet se ishte fituar në mënyrë jo të ligjshme, ndonëse në mungesë në një aktgjykimi dënues.<br><br>Tutje, masat e propozuara me opsionin 3 mund të kenë ndikim edhe në administrimin e mirë të drejtësisë.<br><br>E drejta e prezumimit të pafajësisë së bashku me detyrën e prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e personit të dyshuar, përbënë bazën e e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor të përcaktuar me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (*Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*[19]).<br><br>Në këtë drejtim, propozimi i këtij opsioni që personi i dyshuar të detyrohet që të argumentojë origjinën ligjore të pasurisë së tij, mund të argumentohet se është në kundërshtim me të drejtën për proces të rregullt gjyqësor (Neni 6.1) dhe me të drejtën për prezumim të pafajësisë (neni 6.2).<br><br>Megjithatë, edhe këtu vlen të nënvizohet se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka dhënë vendime negative.<br><br>Shkelja e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor është ngritur në rastin *Phillips kundër Mbrëtërisë së Bashkuar*[20]. *Phillips* ishte dënuar me nëntë vjet burg për importimin e një sasie të madhe të kanabisit. Si rrjedhojë, gjykata kompetente, duke u mbështetur në Ligjin për Drogë të vitit 1994, kishe supozuar që e gjithë pasuria e mbajtur nga Phillips gjatë gjashtë viteve të fundit prej dënmit, është fituar përmes veprës penale.<br><br>Phillips kishe aplikuar pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke argumentuar se ky supozim automatik përbënë |

[19] Shih https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":["saunders%20v%20united"],"documentcollectionid2":["GRANDCHAMBER","CHAMBER"],"itemid":["001-58009"]}.
[20] Shih https://rm.coe.int/09000016806ebe19.

| | |
|---|---|
| | shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt gjyqësor dhe për prezumim të pafajësisë.<br><br>Megjithatë, Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk ishte pajtuar. Sipas kësaj të fundit, e drejta në proces të rregullt gjyqësor nuk është e drejtë absolute dhe se shtetet nën rrethanat e caktuara mund ta kufizojnë atë. Në rastin në fjalë, Mbretëria kishte kufizuar këtë të drejtë duke supozuar se pasuria e mbajtur nga Phillips gjatë gjashtë viteve të fundit prej dënimit, me qëllim të vlerësimit të pasurisë e cila ishte fituar nga kryerja e veprës penale, jo me qëllim të lehtësimit të punës së prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e Phillips.<br><br>Tutje, argumenti se modeli në fjalë mund të jetë në kundërshtim me të drejtën për prezumim të pafajësisë është ngritur edhe në rastin *Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar*[21], i cili kishte të bënte me konfiskimin e një shume të madhe të parave (239,010 £). Ndonëse Britania e Madhe në mungesë të provave kishte dështuar të vërtetojë se Butler kishte fituar paratë si rezultat i trafikut me drogën, e njëjta urdhëroi konfiskimin e tyre sipas procedurës civile.<br><br>Një veprim i tillë nuk u vlerësua të jetë në kundërshtim me nenit 6 (2) të Konventës nga ana e Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas kësaj të fundit, konfiskimi i parave si masë parandaluese e shqiptuar në procedurë civile, nuk mund të krahasohet me sanksionin penal. Rrjedhimisht, edhe Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me prezumimin e pafajësisë nuk është i zbatueshëm për procedura të tilla. Ndaj, nuk mund të ketë shkelje të një të drejte e cila nuk është fare e garantuar në procedurë civile.<br><br>Së fundi, masat e propozuara me opsionin 3 implikojnë edhe të dhënat personale të të dyshuarit. Megjithatë, nuk ka të ngjarë që një cështje e tillë të rezultojë problematike duke marrë parasysh faktin që ky opsion garanton që grumbullimi dhe përdorimi i këtyre të |

[21] Shih https://www.juridice.ro/wp-content/uploads/2015/08/BUTLER-v-THE-UK-ECHR-Decision-_English_.pdf.

| | |
|---|---|
| | dhënave përsonale të jetë në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. |
| **Ndikimi gjinor** | Ndonëse masat e propozuara përmes këtij opsioni nuk merren konkretisht me çështje ë, është e rëndësishme të nënvizohet që provimi i prejardhjes së pronës mund të rezultojë posaçërisht i vështirë për gjininë femrore. |
| **Ndikimet në barazinë sociale** | Nuk ka ndikime. |
| **Ndikimet në rini** | Nuk ka ndikime. |
| **Ndikimet në ngarkesën administrative** | / |
| **Ndikimi në NVM** | / |
| **Ndikimi buxhetor** | Në njërën anë përgjithësisht përmes kësaj politike pritet që të ketë ndikime buxhetore shtesë, në anën tjetër me implementimin e kësaj politike konsiderohet që do të ketë të hyra për buxhetin e shtetit, prandaj duhet të mbështetet kjo iniciativë pasiqë do të ndikoj dukshëm në zvogëlimin e keqpërdorimeve të parasë publike dhe kriminalitet gjithashtu.<br>Edhe pse do të ketë një kosto buxhetore shtesë, përfitimet nga kjo kjo politikë e re do të jenë në masë të konsiderueshme më të larta, parashihet që të themelohet një mekanizëm i ri e cila do t'i ketë afërsisht 30 të punësuar, për më shumë detaje është përgatitur vlerësimi i ndikimit buxhetor. |

### 4.2 Sfidat në grumbullimin e të dhënave

Nuk janë hasur sfida specifike në grumbullimin e të dhënave për analizimin e çështjeve në këtë Koncept Dokument.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Gjatë gjithë procesit të hartimit Ministria e Drejtësisë ka marr parasysh propozimet e akterëve të ndryshëm relevant, konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe

konsultimi me shoqërinë civile. Format e komunikimit kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve tjera përkatëse, ku komunikimi është aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.

Më poshtë, në formë tabelare, janë paraqitur hapa që janë ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me komunikimin dhe konsultimin e këtij Koncept Dokumenti.

*Figura 5: Përmbledhje e aktiviteteve komunikuese dhe konsultuese të zhvilluara për Koncept Dokumentin*

| *Procesi i konsultimit ka synuar:*<br>Marrjen e të gjitha mendimeve nga palët që kanë qenë dhe janë të përfshira në zbatimin e ligjit aktual, që nga problemet, efektet e shkaktuara në praktikë, deri tek ndryshimet që duhet paraparë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qëllimi kryesor | Grupi i shënjestruar | Aktiviteti | Komunikimi/Shpallja | Afati i paraparë | Buxheti i nevojshëm | Personi përgjegjës |
| Takim për prezantimin e përmbajtjeve që do të përfshihen në draftin e parë | Anëtarët e grupit punues | Takim | Ftesa përmes postës elektronike | | | Lulzim Beqiri |
| Pranimi i komenteve lidhur me prezantimet në punëtorinë e kaluar | Anëtarët e grupit punues | Komentimi | Ftesa përmes postës elektronike | | | Lulzim Beqiri |
| Konsultim paraprak me palët e | Anëtarët e zgjedhur | Takime | Përmes postës elektronike | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| interesit për marrjen e komenteve potenciale lidhur me draftin e parë | të grupit punues | | | | | |
| Finalizimi i draftit | Anëtarët e grupit punues | | Shpërndarja përmes postës elektronike | | | |
| Takim i Grupit Punues për të diskutuar draftin | Pjesëtarët e Grupit Punues | Punëtoria | Shpërndarja e dokumenteve dhe komenteve | | | |
| Konsultim publik me shkrim | Të gjitha palët e interesit | Konsultimi elektronik përmes platformës për konsultim publik; | Platforma online për konsultime | 15 ditë pune | | Lulzim Beqiri |
| Takime me palët e interesit | Përfaqësues nga gjyqësori, prokuroria, policia dhe institucione tjera si dhe nga | Punëtori | Ftesa përmes postës elektronike | | | Lulzim Beqiri |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shoqëria civile | | | | | |

Gjatë procesit të konsultimit publik të draft Koncept Dokumentit, janë pranuar komente nga: Zyra e BE-së në Kosovë, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe qytetarët individual. Komentet janë shqyrtuar nga Ministria e Drejtësisë dhe një pjesë e tyre janë inkorporuar ndërsa pjesa tjetër do të përfshihen përshtatshmërisht, aty ku janë të arsyeshme, në kuadër të zbatimit të opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti, që është hartimi i Projektligjit të ri.

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Për adresimin e problemit të parashtruar në këtë analizë, tre opsione janë marrë në konsideratë: opsioni pa ndryshime, sipas të cilit situata aktuale dhe rrjedhimisht vështirësitë e paraqitura në praktikë do të vazhdonin; opsioni 2, i përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative; dhe opsionin 3 që ngërthen në vete dy modelet e tij, të cilat përmbajnë ndryshime legjislative, gjegjësisht, miratimin e një ligji special që rregullon tërë çështjen e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme.

*Opsioni 1* -Opsioni që të mos ndryshohet gjendja aktuale do rezultonte me vazhdimësi të problematikave të identifikuara në këtë Koncept Dokument. Në stadin e tanishëm sa i përket konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, problematikat qëndrojnë si tek mangësitë në kornizën ekzistuese ligjore ashtu edhe tek moszbatimi i duhur dhe efektiv i dispozitave që rregullojnë konfiskimin e pasurisë. Kështu, me vazhdimin e *status quo*, do vazhdojë të ketë stagnim në numrin e konfiskimeve i cili me shumë gjasë do të vazhdojë të mbetet i vogël dhe krahas kësaj do të shfaqet rreziku që kryesit e veprave penale të motivohen edhe më shumë për gjenerimin e të mirave materiale përmes aktiviteteve të tyre joligjore. Rrjedhimisht, do thellohet perceptimi mbi punën jo të drejtë dhe jo profesionale të institucioneve sa i përket demotivimit të suksesshëm të kriminalitetit.

*Opsioni 2* -Procedimi me opsionin e përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative potencialisht mund të ketë si rezultat zbatim më efikas dhe qartësim sa i përket legjislacionit aktual dhe rrjedhimisht edhe ngritje të lakores së rasteve të konfiskimit të pasurisë. Kjo do tentohej të arrihej përmes intensifikimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve zbatuese të ligjit të cilat kanë rol në procesin e konfiskimit e pasurisë. Shtuar kësaj, përmirësimi i zbatimit të kornizës aktuale ligjore do synohej përmes avancimit të kapaciteteve profesionale të akterëve kyç sa i përket konfiskimit me anë të

organizimit të trajnimeve të posaçme si për prokurorët ashtu edhe për gjyqtarët të cilët merren me rastet e konfiskimit të pasurisë e po ashtu edhe rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesional të specializuar. Megjithatë, kur flasim për avancim të kapaciteteve, vlen të theksohet se deri tani janë mbajtur mjaft seminare, takime e vizita madje edhe janë hartuar shkresa ekzemplare për të i'u lehtësuar punën, por përkundër të gjitha këtyre përpjekjeve vazhdon të këtë edhe sot huti tek zbatuesit e ligjit sa i përket konfiskimit. Nga kjo rezulton se ky opsion nuk flet shumë për një përmirësim të mirëfilltë të gjendjes aktuale.

Për më tepër, edhe sikur të arrihej specializimi dhe koordinim më i intensifikuar i organeve përgjegjëse për konfiskim, prapë, legjislacioni në fuqi ndonëse i avancuar si rezultat i hyrjes në fuqi të LKZKP-së, ka fushëveprim të kufizuar sa i përket konfiskimit të pasurisë jolegjitime dhe nuk hapë rrugën për realizimin e konfiskimit me bazë civile. Shtuar kësaj që gjuha e pa unifikuar dhe paqartësitë në mes akteve ligjore relevante me zgjedhjen e këtij opsioni prapë do vazhdonin të ishin prezente. Andaj, mund të thuhet se opsioni përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative ka të ngjarë të jetë i pamjaftueshëm për të bërë eleminimin e problemeve të identifikuara në këtë Koncept Dokument.

*Opsioni 3* - Opsioni për miratimin e ligjit për konfiskimin civil të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme, ka për synim rritjen e përpjekjeve për të dekurajuar në maksimum korrupsionin dhe aktivitetet e tjera kriminale. Me miratimin e një ligji special kemi mundësi që t'u japim organeve ndjekëse dhe atyre gjyqësore, një instrument me të cilin do ta luftojnë krimin përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë dhe të përçojmë mesazhin se krimi nuk paguan dhe se herët apo vonë të gjitha pasuritë e paligjshme do të konfiskohen. Ky opsion jo vetëm do përmirësonte kornizën aktuale ligjore duke lejuar për konfiskim civil por edhe do mundësonte vendosje të fokusit tek konfiskimi i pasurisë përmes caktimit të organeve të specializuara dhe me kompetencë ekskluzive lidhur me konfiskimin e pasurisë të pajustifikueshme. Kjo do mundësonte përshkallëzimin në masë të numrit dhe vlerës së konfiskimeve të pasurisë origjina e të cilave nuk është legjitime dhe e asocuar me krim.

Në anën tjetër të medaljes, shqetësim kryesor për të ndjekur këtë opsion është ndikimi që mund të ketë në cënimin potencial të të drejtave të njeriut, me theks në të drejtën në pronë të qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, ritheksohet se nëse arrihet tejkalimi i këtyre barrierave, duke pasur parasysh dobitë shtesë në kuadër të opsionit 3, i njëjti konsiderohet si më optimali.

Modeli i parë i opsionit 3 (3.1) është më shumë i ekspozuar ndaj problematikave që mund të vijnë me adoptimin e konfiskimit civil. Ai lë më shumë hapësirë për arbitraritet dhe

shkelje eventuale të të drejtave të njeriut. Por, në një këndvështrim gjithëpërfshirës, kjo alternativë e shprehur në modelin e parë do arrijë të përmirësoj numrat e konfiskimit dhe luftimin e kriminalitetit.

Modeli i dytë i opsionit 3 , i cili fton në ndryshimin e kornizës ligjore përmes miratimit të ligjit për konfiskimin civil të pasurisë së fituar në mënyrë të pa justifikueshme të zyrtarëve të lartë publik dhe personave të ekspozuar politikisht, konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm për arritjen e qëllimit të zgjidhjes përfundimtare dhe të qëndrueshme të problemit kryesor. Ky model do kalonte dukshëm, si asnjë opsion tjetër, barrën e provës tek i dyshuari duke lehtësuar kësisoji punën e autoriteteve të autorizuara për konfiskim civil. Nga ana tjetër, targetimi i kategorive të caktuara të personave mbi të cilët do të vlente ky ligj, do të shmangte në shkallë të lartë rrezikun e shkeljes së të drejtave të njeriut që do mund të vijnë në pah me veprimet potenciale arbitrare të zbatuesve të ligjit në drejtim të konfiskimit civil të pasurisë. Për më tepër, këta persona nuk do duhej të përballeshin me vështirësi të theksuara në provimin dhe deklarimin e pasurisë pasi që për këtë ata tashmë në njëfarë nuance vetëm se obligohen përmes ligjit që rregullon deklarimin e pasurisë.

Si përfundim, duke konsideruar dobitë dhe të metat që bartë në vete secili opsion i shtjelluar, opsioni për miratimin e ligjit për konfiskimin civil të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme vlerësohet më i përshtatshëm për të adresuar problematikat e identifikuara në këtë Koncept Dokument, dhe si i tillë do mundësonte avancim të luftimit të efektshëm preventiv dhe korrektiv të kriminalitetit.

## 6.1 Planet zbatuese të opsioneve të ndryshme

## 6.2 Tabela e krahasimit me tre opsionet

Figura 8: Krahasimi i opsioneve

| | **Metoda e krahasimit: Analizë e shumë kritereve** | | |
|---|---|---|---|
| | Opsioni 1: *Status quo* | Opsioni 2: *Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit pa ndryshime në legjislacion* | Opsioni 3: *Miratimi i ligjit special* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kostot përkatëse pozitive** | Nuk ka kosto pozitive përkatëse. | Ka gjasa të rris kurbën e rasteve të konfiskimit. | Do përshkallëzohen numrat dhe vlerat e konfiskimit. |
| | | Mund të rris kapacitet profesionale në kuadër të institucioneve gjegjëse. | Zgjerohet numri i subjekteve ndaj të cilave mund të ndërmirret konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikuar-përtej të dënuarve. |
| | | | Prezantim i standardit më të ulët të të provuarit. |
| | | | Rritë buxhetin e shtetit. |
| **Kostot përkatëse negative** | Sfida në luftimin e duhur preventiv dhe korrektiv të kriminalitetit. | Mund të ketë konfiskim të pasurisë vetëm krahas aktgjykimit dënues. | Mund të lë hapësirë për arbitraritet dhe keqpërdorim. të konfiskimit civil. |
| | Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit. | Nuk do arrihet de-motivim optimal i kriminalitetit. | Ekzistojnë gjasat që raste individuale të konfiskimit civil të shkaktojnë shkelje të të drejtave të njeriut. |
| | Mund të ketë konfiskim të pasurisë vetëm krahas aktgjykimit dënues. | Konfuziteti lidhur me frymën e përgjithshme të sistemit. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Kontribuon në perceptimin mbi punën jo të drejtë dhe jo profesionale të institucioneve sa i përket konfiskimit të pasurisë së fituar me vepra penale. | | |
| | Mos përmirësim në lakoren e rasteve të konfiskimit të pasurisë. | | |
| **Kostot përkatëse** | Është përgatitur vlerësimi i ndikimit financiar i cili është pjesë e shkresave me të cilit ky Koncept Dokument procedohet në Qeveri për shqyrtim dhe miratim | | |
| **Vlerësimi i ndikimit të pritshëm në buxhet** | | | |
| **Përfundimet** | | | |

## Kapitulli 7: Përfundimi dhe hapat e ardhshëm

Ministria e Drejtësisë, si propozues i këtij Koncept Dokumenti, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratojë Opsionin 3 i cili parasheh hartimin e ligjit të ri i cili mundëson realizimin e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues.

Në cilindo rast, Ministria e Drejtësisë beson se miratimi i opsionit nr. 3 i cili mundëson realizimin e konfiskimit në procedurë civile dhe në mungesë të aktgjykimit dënues, do të mundësojë funksionimin e drejtë të sistemit të konfiskimit të pasurisë dhe demotivim të kriminalitetit në vend.

Pas aprovimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë do të fillojë hartimin e Projektligjit, duke marrë në konsideratë analizën e zhvilluar në kuadër të këtij dokumenti dhe më tej.

## 7.1 Dispozitat për mbikëqyrje dhe vlerësim

Draftligji përkatës pritet të aprovohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021 dhe të hyjë në fuqi pas gjashtë muajve. *Vocatio legis* do t'ua mundësojë organeve të përcaktuara t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për mundësimin e zbatimit të duhur të këtij ligji. Pesë vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e ligji të rekomanduar me këtë Koncept Dokument, pritet të kryhet vlerësimi *ex-post* i tij.

## Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

| **Kategoria e ndikimeve ekonomike** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës[22] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në nivelin e pagesës? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | X | | | |
| Bërja e biznesit | A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes? | | X | | | |
| | A do të largohen nga tregu produkte të caktuara? | | X | | | |
| | A do të lejohen në treg produkte të caktuara? | | X | | | |
| | A do të detyrohen bizneset të mbyllen? | | X | | | |
| | A do të krijohen biznese të reja? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ngarkesa administrative | A do të detyrohen bizneset t’i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja? | | X | | | |
| | A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset? | | X | | | |
| Tregtia | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit? | | X | | | |
| | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit? | | X | | | |
| Transporti | A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra? | | X | | | |
| Investimet | A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja? | | X | | | |
| | A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet nga diaspora? | | X | | | |
| | A do të zvogëlohen investimet nga diaspora? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të rriten investimet e huaja direkte? | | X | | | |
| | A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte? | | X | | | |
| Konkurrueshmëria | A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike? | | X | | | |
| | A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike? | | X | | | |
| | A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi? | | X | | | |
| | A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen? | | X | | | |
| Ndikimi në NVM | A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM? | | X | | | |
| Çmimet dhe konkurrenca | A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | | X | | | |
| | A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | | X | | | |
| | A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | X | | | |
| Ndikimet ekonomike rajonale | A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? | | X | | | |
| | A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar? | | X | | | |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike? | X | | | | |
| | A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit? | | X | | | |

## Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

| **Kategoria e ndikimeve shoqërore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | X | | | |
| Ndikimet shoqërore rajonale | A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta? | | X | | | |
| Kushtet e punës | A ndikohen të drejtat e punëtorëve? | | X | | | |
| | A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve? | | X | | | |
| Përfshirja sociale | A do të ketë ndikim mbi varfërinë? | X | | | | |
| | A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale? | | X | | | |
| | A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale? | | X | | | |
| Arsimi | A do të ketë ndikim në arsimin fillor? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e lartë? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim në aftësimin profesional? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen? | | X | | | |
| Kultura | A ndikon opsioni në diversitetin kulturor? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore? | | X | | | |
| Qeverisja | A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik? | | X | | | |
| | A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara? | X | | | | |
| | A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile? | | X | | | |
| Shëndeti dhe siguria publike | A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit? | | X | | | |
| | A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit? | | X | | | |
| | A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)? | | X | | | |
| Krimi dhe siguria | A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët? | X | | | | |
| | A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi? | X | | | | |
| | A ndikon në nivelet e korrupsionit? | X | | | | |
| | A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit? | X | | | | |

## Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

| **Kategoria e ndikimeve mjedisore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm | A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)? | | X | | | |
| | A do të ndikohet konsumi i karburanteve? | | X | | | |
| | A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit? | | X | | | |
| | A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara? | | X | | | |
| Cilësia e ajrit | A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit? | | X | | | |
| Cilësia e ujit | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm? | | X | | | |
| Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës | A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në erozionin e tokës? | | X | | | |
| | A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)? | | X | | | |
| | A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi xxpyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)? | | x | | | |
| Mbeturinat dhe riciklimi | A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara? | | X | | | |
| | A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përdorimi i burimeve | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)? | | X | | | |
| Shkalla e rreziqeve mjedisore | A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore? | | X | | | |
| | A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore? | | X | | | |
| Biodiversiteti, flora dhe fauna | A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë? | | X | | | |
| | A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar? | | X | | | |
| | A do të ndikohet trajtimi i kafshëve? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirëqenia e kafshëve | A do të ndikohet shëndeti i kafshëve? | | X | | | |
| | A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve? | | x | | | |

## Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

| **Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Dinjiteti | A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi? | | X | | | |
| Liria | A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes? | X | | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit? | | X | | | |
| Të dhënat personale | A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? | X | | | | |
| | A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara? | X | | | | |
| | A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale? | X | | | | |
| Azili | A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil? | | X | | | |
| Të drejtat pronësore | A do të ndikohen të drejtat e pronësisë? | X | | U | U | |
| | A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes? | | X | | | |
| Trajtimi i barabartë | A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit? | X | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë ë, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)? | | X | | | |
| Të drejtat e fëmijëve | A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve? | | X | | | |
| Administrimi i mirë | A do të bëhen më të rënda procedurat administrative? | | X | | | |
| | A preket mënyra se si administrata merr vendime (transparenca, koha e procedimit, e drejta për qasje në dosje, etj.)? | X | | L | L | |
| | Për ligjin penal dhe sanksionet e parapara: a preken të drejtat e të akuzuarit? | X | | L | L | |
| | A ndikohet qasja në drejtësi? | | | | | |

## Shtojca 5: Vlerësimi i rëndësisë

Faza e parë përcakton qëllimin e politikës së propozuar, strategjinë, ligjet apo programin (Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës) dhe tregon se si lidhet ajo me barazinë ë (Hapi 2 Kontrolli i rëndësisë)

**Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës**

<table>
<tr><th colspan="3">PËRKUFIZIMI I QËLLIMIT TË POLITIKËS</th></tr>
<tr><td rowspan="7">I.Rëdnësia gjionore – Hapi 1</td><td>Titulli i politikës apo emri i programit</td><td>Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme</td></tr>
<tr><td>Emri i Ministrisë / Institucionit</td><td>Ministria e Drejtësisë</td></tr>
<tr><td>Emri i Departamentit / Njësisë</td><td>Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave</td></tr>
<tr><td>Drejtorati apo Agjencia</td><td></td></tr>
<tr><td>Korniza ligjore</td><td>Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lista kontrolluese 1 – Si qëndron gjendja</td></tr>
<tr><td>Në fushën e politikës në fjalë, a ekzistojnë dallime ndërmjet mashkujve dhe femrave në <u>organizatën punuese të bazuar në gjini</u>?<br>⇒ A janë të grupuara vendet e punës për femra?</td><td>Jo.<br><br>Jo.<br>Jo.</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | ⇒ A marrin femrat paga jo të barabarta?<br>⇒ A ekziston paragjykimi se njerëzit janë të lirë nga përgjegjësitë e kujdesit?<br>⇒ A janë analizuar dallimet në mes femrave dhe meshkujve në grupe të ndryshme kulturore/komunitete? | ?<br>Po.<br>? |
| | ⇒ A ekzistojnë dallime domethënëse në **organizimin e marrëdhënieve personale?**<br>⇒ A janë femrat kryesisht përgjegjëse për kujdesin në familje?<br>⇒ A nënkupton politika në fjalë transformimin e normave ekzistuese? | Jo.<br>Po, kryesisht gratë janë përgjegjëse për kujdesin në familje.<br>Jo. |
| | A ekziston **shpërndarje jo e barabartë e burimeve** ndërmjet grave dhe burrave? | Jo. |
| | Çfarë **rregullash** ekzistojnë? (Për shembull, a janë më pak të çmueshme rolet dhe aktivitetet e femrave?) | Nuk ka. |

| | | |
|---|---|---|
| | Si do ta **vlerësonit gjendjen aktuale** në fushën e sektorit/politikës sa i përket:<br>⇒ barazisë?<br>⇒ autonomisë?<br>⇒ kujdesit / marrëdhënies?<br>⇒ diversitetit? | ? |
| | A i keni të dhënat për t'u përgjigjur në këto pyetje? * | Jo. |
| | *Lista kontrolluese 2 – Si do të jetë gjendja* | |
| | A ka një plan për të krijuar politikë/program të ri apo për ta ndryshuar një politikë? | Po |
| | **Përshkrim i shkurtë** i politikës/programit të propozuar (apo ndryshimet e një politike që duhen bërë) | Politika e propozuar është aprovimi i një ligji të ri i cili do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues dhe i cili do të transferojë barrën e provës prej prokurorisë tek personat e dyshuar. |
| | Cilat **rezultate** i kontribuojnë politikës/programit të propozuar (apo ndryshimeve të një politike që duhen bërë)? | Miratimi i ligjit në fjalë. |

| | | |
|---|---|---|
| | Çfarë synon të arrijë politika e propozuar (apo ndryshimet e politikës)? **(Qëllimet)** | Shih Kapitullin 2 për përshkimin e hollësishëm të objektivave. |
| | A përputhen qëllimet dhe rezultatet e politikës/programit (apo ndryshimeve të politikës) me **promovimin e barazisë ë?** | / |
| *Përgatitur nga [emri (at) dhe pozita(t)]* | | |

* Mund të jetë e nevojshme mbledhja e statistikave ekzistuese të zbërthyera sipas gjinisë, të përdoren matje cilësore dhe sasiore, dhe të bëhen konsultime me burra dhe gra të cilët mund të jenë të prekur nga politika (grupe punuese, kontribute nga ekspertë të jashtëm)

**Hapi 2 Kontrolli i rëndësisë ë**

| **KONTROLLI I RËNDËSISË** | | |
|---|---|---|
| *I.Rëndësia gjionre – Hapi 2* | **Titulli i politikës apo emri i programit** | Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme |
| | **Emri i Ministrisë / Institucionit** | Ministria e Drejtësisë |
| | **Emri i Departamentit / Njësisë** | Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave |
| | **Drejtorati apo Agjencia** | |
| | **Korniza ligjore** | Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. |
| | *Informacion sqarues* | |
| | **Përshkrimi** i politikës/programit të propozuar (apo ndryshimeve | Politika e propozuar është aprovimi i një ligji të ri i cili do të mundësojë konfiskimin e |

| | |
|---|---|
| të politikës që duhen bërë) dhe objektivat e saj | pasurisë së pajustifikueshme edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues. |
| Përshkrimi i **<u>grupit/grupeve të targetit</u>** të politikës/programit të propozuar | Të gjithë personat fizik dhe juridik; gjykatat dhe prokuroritë publike; policia, agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar. |
| Informatë lidhur me atë se kush mund të ndikohet potencialisht nga politika/programi i propozuar. | Ndikimi do të shtrihet në të dy gjinitë (femrat dhe meshkujt). Ndonëse, ekziston mundësia që femrat të rëndohen më shumë me masat e propozuara me këtë opsion marrë parasysh që vërtetimi i prejardhjes së provës mund të rezultojë posaçërisht i vështirë për to. |
| ***Përfituesit e drejtpërdrejtë*** | |
| Pjesëmarrja sipas gjinisë | Pjesëmarrja sipas gjinisë do të jetë: femrat dhe meshkujt |
| Burimet sipas gjinisë | Të dy gjinitë. |
| Vlerësimet dhe vlerat sipas gjinisë | - |
| Të drejtat sipas gjinisë | - |
| ***Përfituesit e tërthortë*** | |
| A ka përfitues të tërthortë të politikës/programit të | |

| | | |
|---|---|---|
| | propozuar (p.sh. të afërmit e përfituesit të drejtpërdrejtë, qytetet fqinje, ...)? | |
| | Si do të ndikohet secili grup i përfituesve të tërthortë nga politika/programi i propozuar?<br>⇒ Ndikimi pozitiv<br>⇒ Ndikimi negativ | |
| | ***Vlerësimi*** | |
| | A ekzistojnë indikacione apo dëshmi të pjesëmarrjes së lartë apo të ulët apo të pranimit nga grupet e ndryshme? ('normë e lartë, e ulët apo e mesme e ndikimit') | |
| | A ekzistojnë indikacione apo dëshmi se grupet e ndryshme kanë nevoja, përvoja, çështje dhe prioritete të ndryshme në lidhje me politikën/programin e propozuar? ('normë e lartë, e ulët apo e mesme e ndikimit') | |

| | | |
|---|---|---|
| | A kanë treguar konsultimet paraprake me grupet, organizatat apo individët relevant se politikat e caktuara krijojnë probleme të veçanta për ta? ('normë e lartë, e ulët apo e mesme e ndikimit') | |
| | A ekzistojnë mundësi për promovim më të mirë të mundësive të barabarta apo marrëdhënieve të mira duke ndryshuar politikën/programin e propozuar? | Po, ekzistojnë mundësi për promovimin e mundësive të barabarta dhe marrëdhënieve të mira përmes ndryshimit të politikës/programit të propozuar. |
| | *Përfundimi* | |
| | Cili është përfundimi? *<br>⇒ Arsyetimi<br>⇒ Çështjet kryesore, nëse ka<br>⇒ Grupet e fokusit, nëse ka | Ekziston rëndësia ë e politikave të propozuara. |
| *Përgatitur nga [emrit(at) dhe pozita(t)]* | | |

* Ose nuk ka ndryshime në politika, funksione apo shërbime (p.sh. raporti 'vetëm për informim'), ose tashmë është kryer rishtazi IAG (E); është e qartë se nuk ka relevancë ë; apo vlerësimi i plotë në qoftë se kërkohet masa e ndikimit

**II. Vlerësimi i ndikimit gjinor**

Kjo fazë është e nevojshme për arritjen e barazisë ë dhe zhvillim të barabartë përmes politikës/programit të propozuar (Hapi 3 Analizë e ndjeshmërisë ë). Bazuar në gjetjet e grumbulluara nga faza paraprake, ajo shqyrton gjithashtu edhe opsionet e ndryshme dhe vlerëson ndikimin pozitiv dhe negativ në grupet e shenjës truara (hapi 4 Shkalla e matjes ë).

**Hapi 3 Analizë e ndjeshmërisë ë**

| ANALIZË E NDJESHMËRISË Ë * | | |
|---|---|---|
| *II. Vlerësimi i ndikimit gjinor – Hapi 3* | **Titulli i politikës apo emri i programit** | Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme |
| | **Emri i Ministrisë / Institucionit** | Ministria e Drejtësisë |
| | **Emri i Departamentit/Njësisë** | Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave |
| | **Drejtorati apo Agjencia** | |
| | **Korniza ligjore** | Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. |
| | *Analizë e ndikimit*** | |
| | A ka dëshmi për natyrën e problemit? | Po, ekziston dëshmi lidhur me natyrën e problemit. |
| | Cili është ndikimi potencial i politikës? (Pozitiv/Negativ/Neutral) | Ndikimi potencial i politikës është i natyrës pozitive. |
| | Në qoftë se ka ndikim: ⇒ Si do të ndikojë politika/programi i propozuar tek meshkujt dhe femrat? (rendit ndikimet kryesore) | Politika e propozuar është aprovimi i një ligji të ri i cili do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme edhe në mungesë të një aktgjykimi dënues. |

| | | |
|---|---|---|
| ⇒ Kush do të preket? (për secilin ndikim kryesor)<br>– drejtpërsëdrejti<br>– tërthorazi<br>⇒ Përmbledhje e dëshmive (për secilin ndikim kryesor) | | |
| ***Mundësitë për promovimin e ndikimit pozitiv*** | | |
| Në qoftë se nuk ka ndikim, a ekzistojnë mundësitë për zhvillimin e politikave në atë mënyrë që promovojnë ndikimin pozitiv apo politika gjini-transformuese? | Jo, nuk ekzistojnë. | |
| ***Shqyrtimi i dëshmive*** | | |
| | *Përmbledhje e shkurtë* | *Dëshmi mbështetëse (cilësore dhe sasiore) **** |
| Cilat janë dallimet ë në këtë çështje? Keni parasysh ndikimet e ndryshme/të dallueshme të ndikimeve për gratë dhe burrat dhe identifikoni pasojat në vijim:<br>⇒ Rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave (brenda sektorit) | Nuk ekzistojnë dallime. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | ⇒ Asetet dhe burimet me të cilat merren gratë dhe burrat (lidhur me politikat e propozuara)<br>⇒ Pushteti dhe vendimmarrja në të cilin gratë dhe burrat marrin pjesë në nivele të ndryshme siç është familja, komuniteti, karriera)<br>⇒ Nevojat, prioritetet dhe perspektiva e grave dhe burrave | | |
| | Cilët janë faktorët ndikues social, kulturor, ekonomik dhe politik? Identifiko dallimet ndërmjet grave dhe burrave në fushën(at) e analizës së ndikimit për nga:<br>⇒ Pjesëmarrja (përfaqësimi i grave dhe burrave në pozita vendimmarrëse, përbërja ë e grupeve të shënjestruara...)<br>⇒ Burimet (koha, vendi, informimi, pushteti politik dhe ekonomik, arsimi dhe | Nuk janë relevante për politikat që kemi adresuar. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | aftësimi, puna, teknologjitë e reja, shërbimet shëndetësore, strehimi, edukimi, mobiliteti, ...)<br>⇒ Normat dhe vlerat (rolet, qëndrimet dhe sjelljet respektive të grave dhe burrave, pabarazitë në përshkrimin e stereotipave të burrave dhe grave, ...)<br>- ndarja e punës sipas gjinisë<br>– organizimi i jetës private<br>– organizimi qytetar<br>⇒ Të drejtat themelore (njerëzore, qytetare, të drejtat politike, diskriminimi gjinor i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, qasja në drejtësi,...) | | |
| | Çfarë politikash/legjislacioni ekziston në këtë fushë? A pasqyrojnë ato dëshminë ë që keni identifikuar? | Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligji për | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. | |
| | A ka pasur ndonjë ndryshim gjinor-reagues në këtë fushë? Nëse po:<br>⇒ Cilat janë ato?<br>⇒ Si kanë ndodhur këto ndryshime? | | |
| | A kanë shkaktuar ndonjë ndryshim të matshëm në përvojat e grave deri më sot? Nëse jo:<br>⇒ Pse jo?<br>⇒ A nuk ka pasur lobim?<br>⇒ A kanë qenë jo efektive metodat e lobimit?<br>⇒ A ka ndonjë pengesë tjetër të identifikuar? | | |
| | A i adreson politika e propozuar nevojat e grave dhe burrave, duke marrë parasysh interesat e tyre të ndryshme, rolet dhe pozitat? | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Identifiko mundësitë për mbështetjen e nevojave praktike të grave dhe interesat strategjike për të kontribuar në mënjanimin e pabarazive ekzistuese dhe për të promovuar barazinë ndërmjet grave dhe burrave:<br>⇒ Në shkallë pjesëmarrjeje<br>⇒ Në shpërndarjen e burimeve, përfitimeve, detyrave dhe përgjegjësive në jetën private dhe publike<br>⇒ Në vlera dhe vëmendje që i kushtohen karakteristikave, sjelljeve dhe prioriteteve meshkujve dhe femrave? | | |
| | A do të promovojë politika/programi i propozuar...:<br>⇒ mundësi të barabarta<br>⇒ marrëdhënie të mira<br>... ndërmjet personave të gjinive të ndryshme? | | |
| | *Përmirësimet e sugjeruara, rishikimi i masave lehtësuese dhe/ose politikave alternative* | | |

| | | |
|---|---|---|
| | Në qoftë se identifikohet ndonjë ndikim negativ, çfarë masash mund të merren për të zvogëluar ndikimin negativ të politikës? | |
| | Në qoftë se është identifikuar ndonjë ndikim pozitiv, çfarë masash mund të merren për ta rritur ndikimin pozitiv të politikës? | |
| *Përgatitur nga [emri(at) dhe pozita(t)]* | | |